



WFD



KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG



Right – Wing Ideas

for

Albania

Conservatives

POLITICAL
SUMMER SCHOOL

July, 2022



IDU

The Global Alliance
of the Centre Right

IDETË E DJATHA PËR SHQIPËRINË

nga pjesëmarrësit e Shkollës Politike Verore

ESE



IDETË E DJATHA PËR SHQIPËRINË

*Përmbledhje me ese nga pjesëmarrësit e
Shkollës Politike Verore*

Pogradec 13-15 korrik 2022

Nga 13-15 korrik 2022, u zhvillua Shkolla Politike Verore, “Idetë e Djathta dhe Konservatore për Shqipërinë”, organizuar nga ACGG (Qendra Shqiptare për Qeverisje të Mirë), me mbështetjen e Fondacionit Britanik për Shqipërinë (WFD) dhe në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman KAS (Konrad-Adenauer-Stiftung Albanien).

Mbi 20 të rinj e të reja morën pjesë, nuk janë thjeshtë audienca e një programi intensiv trajnimi, por një klub mendimi dhe ekip drejtuesish politikë që i duhen Shqipërisë nesër! Faleminderit secilit prej tyre dhe në veçanti, Drejtorit të WFD, z. Sokol Haxhiu, Drejtorit të KAS, Dr. Tobias Rüttershoff, lektorëve dhe miqve tanë; Adri Nurellari, Arta Sakja, Edlira Gjoni, Fitim Zekthi, Altin Gjeta, Ethem Fezollari etj!

Dita e dytë nisi me bashkëpunëtoreshen e vyer të ACGG/KAS, znj. Edlira Gjoni, e cila ofroi një trajnim bashkëkohor për komunikimin politik në publik dhe vijoi me ekspertin Arta Sakja, politologun Altin Gjeta.

Në ditën e tretë u paraqit një tablo e organizimit të së djathtës europiane dhe asaj konservatore nga Arben Çejku, drejtor Ekzekutiv i ACGG ndërsa mësimet nga e kaluara i solli z. Ethem Fezollari, Kryetari i Shoqatës Antikomuniste dhe ish-te përndjekurve politikë. Ai tregoi kalvarin e vuajtjeve në diktaturë dhe se si në vitin 1975 u arratis bashkë me 15 anëtarë të tjerë të familjes përmes liqenit të Pogradecit me një varkë të vogël të improvizuar me mushama.

Në vijim pjesëmarrësit paraqitën disa ese mbi këndvështrimin e tyre rreth vlerave të së djathtës dhe konservatorizmit në politikën shqiptare, të cilat i përzgjedhëm për këtë botim special.

Kejsi Tola, Imanuel Çaushti, Megi Perduka, Lukas Heidorn, Sention Zotaj, Edison Mehqemeja, Mikaela Pinari, Iva Hasko, Irisa Çupa, Ina Metalia, Valbona Halitaj, Dhimitri Sino, Izmir Xhafa, Aurela Kalthi, Ilda Lekgega, Armando Lekaj, Tea Sollaku, Klea Dahari, Emanuel Toska dhe Denis Bendo ishin pjesëmarrës në këtë shkollë.

Në fund u ndanë Çertifikatat e pjesëmarrjes.

Përmbajtja e lëndës

Zhvillimi i ekonomisë sipas konceptit të djathtë	5
Zhvillimi i Mirëqënies Sociale – e djathta si modeli më i mirë	8
Konservatorizmi për modelin qeverisës	11
Kur mendojmë për të djathtën ekstreme...	14
Tregu dhe sipërmarrja sipas konceptit të djathtë	17
Nevoja e Shqipërisë për më shumë konservatorizëm	23
Liria ekonomike, si kusht për demokraci	27
Ideologjia e djathtë liberal-konservatore	30
Vijat ideologjike mes partive kryesore në Shqipëri	35
Për rikthimin tek republika parlamentare	38
Për një parti reale me vlera konservatore	41
Tezat e djathta në Shqipëri	44
Si duhet të jetë një qeverisje e djathtë	47
Nevoja për një edukim politik të rinisë	50

E djathta, e vetmja shpresë për ndryshim	53
Zhvillimi i Shqipërisë sipas ideve të djathta dhe konservatore	56
Pse ikin të rinjtë?	60
Vlerat e së djathtës shqiptare	64

ZHVILLIMI I EKONOMISË SIPAS KONCEPTIT TË DJATHTË



Armando Lekaj

Shqipëria, aktualisht gjendet në rrethana të tilla ekonomiko-shoqërore, ku nevoja për përmirësim dhe ndërhyrje është imediate.

Në këto kushte, duhet një analizë e thellë e gjëndjes aktuale, e ndjekur nga diskutime të rrafshit politik themelor.

Ndërtimi i një modeli të qartë ideologjik (të djathtë) i hartimit dhe trajtimit të politikave të djathta qeverisëse, është hapi i parë drejt një ndryshimi të duhur dhe të qëndrueshëm. Ekonomia është sektori më i rëndësishëm, i cili duhet t'u nënshtrohet forcave të tregut të lirë.

Orientimi drejt një ekonomie tregu të lirë, me rregullime minimale nga ana e shtetit është hapi i parë dhe në këtë rast shteti, mund të konsiderohet vetëm si rregullator dhe jo si diktues dhe kontrollues i tregut.

Tregu i lirë është mjedisi më i përshtatshëm për zhvillimin e aktivitetit ekonomik, prandaj favorizohet privatizimi i industrisë dhe sektorëve të tjerë të ekonomisë së dikurshme të centralizuar. Synimi është gjithmonë konsolidimi i fitimit

dhe mbrojtja e pronës private, si e drejtë legjitime e zotëruesve te saj. Kështu theksohet rëndësia e individualizimit dhe e ekonomisë së tregut të lirë.

Shqipëria, përveç periudhës së komunizmit, është prirur gjithmonë drejt parimeve të tilla liberale përsa i përket tregut. Komunizmi, si system i ekonomisë së centralizuar, pati një ndikim të madh duke deformuar parimet e ekonomisë së lirë dhe duke krijuar vështirësi të mëdha për ngritjen e një ekonomie të lirë pas viteve '90. Problemet e krijuara gjatë atij regjimi monist, ku si askund tjetër ekonomia u centralizua dhe u shtetëzua plotësisht, ndjehen edhe sot në procesin e një ekonomie të lirë dhe liberale. Problemet me ligjshmërinë e pronave, mbivendosja e së drejtës së pronës nga individë të caktuar dhe anarkia juridike kanë penguar krijimin e një ekonomie të mirëfilltë tregu, siç përshkruhet në teorinë e së djathtës dhe siç është në vendet kapitaliste.

Disa nga iniciativat kryesore, që mund të ndërmerren sot në funksion të mbështetjes së tregut të lirë janë; ulja e taksave dhe ndërhyrje për uljen e normave të interesit. Këto masa rrisin mundësitë e bizneseve për financim dhe zgjerim, në funksion të konsolidimit dhe rritjen e impaktit pozitiv drejt rritjes së mirëqënies dhe fuqisë blerëse. Gjithashtu, normat e taksimit duhet të orientohen drejt kuotave minimale, ku ndërhyrje konkrete në sistemin aktual, mund të jenë ulja e taksave mbi të ardhurat personale, ulja e taksave mbi fitimin për bizneset, ulja e masës së sigurimeve shoqërore, ulja e vlerës së taksave në % të karburanteve, ulja e taksave dhe tarifave vendore mbi bazën e xhirove të biznesit në vitin fiskal etj.

Në pikëpamjen sociale, konservatorizmi shoqëror është karakteristikë dalluese e spektrit të djathtë, duke promovuar institucionet tradicionale, të drejtën e pronës (veçanërisht pronën private), familjen, rendin hierarkik etj. Ekonomia sociale e tregut, është një tipar dallues i kapitalizmit gjerman,

i cili ka në qendër të vëmendjes qytetarin e pamundur për të krijuar sipërmarrje apo që ka nevoja bazike, që duhen mbuluar nga shteti. Fytyra sociale e kapitalizmit, është një tipar dallues për kapitalizmin e ditëve tona dhe, ky model duhet zbatuar në Shqipëri.

Të gjitha reformat e ndërmarra dhe ato që duhen ndërmarrë, shkëpusin Shqipërinë nga modeli komunist apo post-komunist. Bëhet i qartë ripërcaktimi i plotë i qëndrimit pro-evropian, duke ruajtur vlerat dhe cilësitë dalluese autoktone por duke përqafuar motivet e përgjithshme të komunitetit evropian. Shqipëria në historinë e saj, përveç periudhës së komunizmit është përpjekur të konfirmojë qëndrimin e saj pro-evropian.

Së fundmi, ky qëndrim është zbehur dhe mbuluar me hije dyshimi nga iniciativa zonale ballkanike, që nuk janë plotësisht të qarta, nëse afrojnë me komunitetin evropian apo na distancojnë. Nevojitet një ristrukturim i qëndimit të shtetit shqipëtarë, i qartë në zbatimin e reformave që synojnë përafrimin e legjislacionit shqipëtarë me atë evropian si dhe ratifikimin e marrvëshjeve dhe kodeve ndërkombëtare pro-evropiane si dhe zbatimi real i tyre.

Mbrojtja e të drejtave kombëtare të Shqipëtarëve është një element tjetër, që i duhet kushtuar rëndësi në funksion të konsolidimit të së djathtës shqipëtare.

E drejta e emigrantëve për të votuar mund të jetë një shembull i aplikimit të këtij parimi. Pavarsisht asaj që është kryer mbetet edhe shumë për të bërë për të djathtën shqipëtare.

Pogradec më, 13 korrik 2022

ZHVILLIMI I MIRËQËNIES SOCIALE – E DJATHTA SI MODELI MË I MIRË



Aurela Kalthi

Në një sistem presidencial Qeveria vendos dhe ndërmerr politikat shtetërore dhe është Parlamenti insitucioni para të cilit ajo duhet të bëjë transparencën e veprimtarisë së saj.

Ky sistem i kërkesës së llogarisë dhe llogaridhënies nuk është se ka funksionuar mirë në Shqipëri.

Të gjitha qeveritë premtojnë pafund përgjatë fushatave elektorale, shpeshherë jo me programe të qarta, të konsultuara me grupe interesi apo ekspertësh, por thjesht nëpërmjet ligjërimeve të liderit kryesor të Partisë.

Të gjitha qeveritë, si ato që vijnë nga e majta dhe ata që vijnë nga e djathta premtojnë rritje të mirëqenies sociale të qytetarëve.

Por çfarë duhet të kuptojmë me mirëqënien sociale ? Si matet ajo? Ku ndryshojnë politikat e djathta me ato të majta në rritjen e saj?

Nocioni i mirëqenies sociale nuk është një përcaktim i lehtë për t'u bërë, sepse nën këtë togfjalësh duhet të kuptohet një shumësi aspektesh si: një cilësi e mirë jetese, një shëndet fizik e mendor i mirë, një nivel i mirë jetese, një inivel i mirë i

integimit shoqëror të grupeve të ndryshme si edhe akses të mirë në të drejtat sociale.

Të gjitha këto lidhen me familjen, kujdesi ndaj ruajtjes së çllës është shtyllë e programeve të djathta.

E djathta kërkon ndryshime të mirëqënies me një orientim më të fortë drejt drejtësisë së bazuar te performanca, për sa i përket modelit të tyre të shtetit të mirëqënies. E djathta kërkon përqendrimin e saj më të fortë te ndihma e shtetit të mirëqënies në aspektin e parimit të subsidiaritetit

E majta është shumë më e orientuar drejt një kombinimi të drejtësisë të bazuar te nevoja dhe barazisë së mundësive, që duhet të zbatohet përmes të drejtave themelore gjithëpërfshirëse dhe të garantuara nga shteti.

Ato ndryshojnë ndjeshëm në lidhje me konceptimin e tyre mbi rolin e ndërhyrjes së shtetit, por edhe se si duhet të zbatohen këto kërkesa themelore.

Të gjithë bien dakord që Shteti është i detyruar për nga misioni i tij që të punojë për të siguruar rritjen e mirëqënies së qytetarëve. Për të bërë këtë gjë ai ndërmerr masa dhe politika të nevojshme për të korrigjuar padrejtësitë që gjeneron tregu. Shpërndarja e të ardhurave dhe zhvillimi i shërbimeve sociale të lira e falas për të gjitha personat që duhet të arrijnë një mirëqënie më të lartë. Mundësia e shpërndarjes së të mirës sociale ndërlidhet me nocion e pasurisë, si edhe me fondet shtetërore. Ndaj mënyra sesi këto fonde shpërndahen kategorizon githashtu qeveritë e ndryshme.

Mirëqenia sociale matet me terma ekonomikë dhe ndër më kryesorët mund të përmendim: Rishpërdarjen e pagës, përqindjen e papunësisë, të ardhurat për frymë, shpenzimet sociale, nivelin e konsumit, nivelin shëndetësor, nivelin

e varfërisë, atë të shkallës së edukimit, liritë qytetare dhe sigurinë sociale.

Zhvillimii këtyre parametrave tregon suksesin e politikave qeverisë në këtë drejtim, pasi shteti ka rolin kryesor në këtë drejtim për shembull krijimi nga ana e shtetit i masave politike me synim rishpërndajen e të ardhurave. Një aplikim efikas i këtyre masave rrit mirqënien e qytetarëve.

Por nëse shteti nuk arrin t'i zbatojë drejt këto masa ndodh efekti i kundërt, Kështu për shembull korrupsioni ka një ndikim të drejtpërdrejtë në mosrritjen e nivelit të mirëqenies.

Si përfundim, mund të themi që mirëqenia sociale e qytetarëve rritet më shumë nëpërmjet politikave të djathta, pasi ato bazohen tek performanca e individit, tek ndihma për të ruajtur konceptin e familjes dhe duke qenë qeveri më të vogla, janë më të kontrollueshme nga Parlamentet dhe për rrjedhojë më pak të korruptueshme.

Pogradec, 13 korrik 2022

KONSERVATORIZMI PËR MODELIN QEVERISËS



Denis Bendo

Sa e bukur është Shqipëria.... një vend plot bukuri natyrore dhe kulturore.... të shkatërruara nga politika. Vitet e fundit Shqipërinë e ka zënë një ngërç në zhvillimin e vendit, për shkak të keqqeverisjes dhe arrogancës së pushtetarëve. Në cilëndo fushë që të futemi për diskutim, do të hasemi me probleme dhe prapambetje.

Në ditët e sotme qeveria ka marr nën kontroll të plotë shtetin; është futur thellë në shoqërinë shqiptare. Çdo gjë kontrollohet nga shteti, si ekonomia, tregu, arsimi, etj. Rregullat e tregut sot në Shqipëri vendosen nga pushtetarët, të cilin nuk mund ta quajmë më “tregu i lirë”.

Një përqindje e madhe e popullsisë, kryesisht të rinjtë, dëshirojnë të largohen nga Shqipëria, pasi këtu nuk shohin të ardhme. Njerzit ndjehen pa vizion dhe synim. Çdo biznes është drejt falimentimit dhe kjo për shkak të rritjes maksimale të taksave dhe rregullave të rrepta të qeverisë. Në shoqërinë shqiptare nuk ka më shumë se dy shtresa; e pasura dhe varfra! Pra, nuk ekziston një shtresë e mesme, e cila bën një jete normale. Një sektor tjetër që po shkon drejt shkatërrimit është edhe kultura, e cila po jepet me koncensione të dyshimta.

Kohëve të fundit, madje kemi dëgjuar se po jepen me koncesione pasuri te lashta arkeologjike, sete kulturore, pjesë bregdetare të mbrojtura etj.

Por, a do të ndodhte kështu, nëse Shqipëria do të drejtohej nga idetë konservatore (të djathta)?

Do të thoja jo! Do të thoja “jo”, sepse idetë Konservatore janë të bazuara tek interesi publik dhe kombëtar dhe synojnë zhvillimin e vendit dhe jo keqpërdorimin e pronës publike për interesa personale të politikanëve të caktuar..

Një prej ideve kryesore konservatore lidhet me rolin që duhet të ketë qeveria në jetën publike. Sipas konservatorëve, roli i qeverisë duhet të jetë minimal, aq sa për të mos u bërë pengesë për zhvillimin e ekonomisë së lirë të tregut dhe funksionimin demokratik të institucioneve shoqërore.

Politikat konservatore që zhvillojnë ekonominë e lirë të tregut dhe vënë institucionet në shërbim të qytetarit, do të ulnin trendin e largimit masiv të njerëzve.

Një tjetër ide konservatore ka të bëjë me tregun e lirë, në të cilin qeveria nuk duhet të përfshihet thellësisht, pasi një qeveritar nuk vendos dot se sa mund të shitet qumështi, sa paguhet një inxhinier etj. Këto duhet t'i përcaktojë vetë tregu. Nëse ja lë në dorë shoqërisë kjo gjë do të rriste konkurrencën dhe nëse rritet konkurrenca, cilësia e çdo shërbimi do të rritej, sepse çdokush dëshiron të fitojë nëpërmjet konkurrencës së lirë.

Konservatorët janë pro taksave të ulta, pasi në këtë mënyrë stimulohen njerëzit dhe bizneset që të zhvillohen më tepër. Kjo politikë do të çonte në krijimin e shtresës së mesme, të cilën mund ta quajmë motor të zhvillimit shoqëror.

Kultura dhe tradita, janë tipare të konservatorizmit që duhen zhvilluar dhe konsoliduar në Shqipëri. Ato jnaë djepi i një

shoqërie demokratike, pasi indentifikojnë popujt përkatës. Qeveria nuk duhet t'i shesë apo t'i japë me konçesione asetet kombëtare të kulturës dhe historisë sonë, por duhet të investojë për shtimin dhe mbrojtjen e tyre.

Më pëlqen dhe do të doja që Shqipëria të filloj të drejtohet nga ide konservatore pasi është e vetmja mënyrë efikase për zhvillim.

Pogradec, 13 korrik 2022

KUR MENDOJMË PËR TË DJATHTËN EKSTREME...



Dhimitri Sino

Kur mendojmë për të djathtën ekstreme (far-right), mendja na shkon tek tipare ideologjike, si antisemitizmi dhe racizmi apo dhe tek çështjet politike si imigracioni dhe siguria.

Edhe pse lëvizja e së djathtës ekstreme është tejet e larmishme edhe përbrenda dy nën-grupeve të saj (të djathtës radikale dhe ekstremit të djathtë), këto grupe dhe parti, megjithatë kanë një sërë tiparesh ideologjike dhe kauzash politike të përbashkëta.

Fillimisht do të diskutojmë ideologjitë kyçe, brenda ekstremit të djathtë, respektivisht Fashizmin dhe Nazizmin, si dhe veçoritë kryesore të së djathtës radikale (populiste), përkatësisht: nativizmin, autoritarizmin dhe populizmin. Më pas do të vijojë duke shqyrtuar atë se, si këto tipare ideologjike manifestohen në raport me çështjet kryesore të së djathtës ekstreme të valës së katërt. Imigracionin, sigurinë, korrupsionin dhe politiken e jashtme.

Ideologjitë e ekstremit të djathtë besojnë se pabarazitë janë të natyrshme dhe se ato nuk janë në dorë të shtetit. Në këto ideologji, dallimet dhe hierarkia kremtohen, ndërkaq elitizmi

është veçori thelbësore, e cila mbështet idenë se disa grupe dhe individë janë superiorë karshi të tjerëve dhe, rrjedhimisht duhet të kenë pushtet më të madh.

Grupet dhe idetë e së djathtës ekstreme janë të shumta dhe të ndryshme dhe shpesh papajtueshmëritë e tyre janë më të mëdha, sesa pajtueshmëritë. Për shembull, monarkistët absolutist dhe racistët pajtohen se baza e pushtetit është gjaku, por të parët i referohen ekskluzivisht trashëgimisë (linjës) mbretërore, ndërsa të dytët u referohen dallimeve të supozuara raciale. Disa teokratë besojnë se pushteti më i lartë buron nga Bibla apo Talmudi. Ndërsa, fashistët e shohin atë tek personi i liderit.

Unë po fokusohem ekskluzivisht në grupet e së djathtës ekstreme, të cilat bazojnë identitetin e tyre në kategori etnike dhe raciale, që do të thotë se këtu nuk do të diskutohet për ato grupe, të cilat janë në thelb monarkiste dhe fetare dhe për të cilat dallimet etnike dhe raciale janë dytësore apo të parëndësishme.

E kemi vënë re dhe në Shqipëri, që ne kemi një elitë të fshehur për popullin kemi biznesmë fantazëm pafund, duke bërë të besojmë që ata janë në krye të hierarkisë së shtetit. Çështja e imigracionit, përfshinë dy aspekte të ndryshme por të ndërlidhura: imigracionin dhe integrimin. Për një kohë të gjatë, imigracioni ka qenë njëra nga çështjet boshtore të pothuajse secilit grup të së djathtës ekstreme në Europë dhe Amerikë Veriore, por kohë pas kohe kjo çështje luan rol të rëndësishëm edhe në disa vende në rajonet tjera (si p.sh në Brazil apo Japoni).

Partitë e djathta radikale në mënyrë tipike thonë se “imigracioni masiv” përbën një kërcënim ekzistencial për kombin dhe shtetin e tyre, ndërsa grupet e ekstremit të djathtë janë më të shqetësuara për racën, dhe thonë se vendet perëndimore

ballafaqohen më një “gjenocid ndaj të bardhëve”, për shkak të imigracionit masiv dhe multikulturalizmit të sponsorizuar nga shteti.

Në shekullin e njëzetën, teoria konspirative e “Zëvendësimit të Madh” (The Great Replacement) është në zemër të retorikës anti-imigracion të së djathtës radikale populiste – dhe çdo ditë e më shumë, i të djathtës mainstream.


E popullarizuar nga autorë francez si Jean Raspail dhe Renaud Camus, por e inspiruar nga një traditë antisemitike dhe raciste e shekullit të nëntëmbëdhjetë, kjo tezë thotë se “Perëndimi” po gëlon nga një “batice” e imigracionit jo-Perëndimor.

Politikanët populistë të së djathtës radikale besojnë se imigracioni masiv nuk është i nxitur nga varfëria në vendet në zhvillim, por i organizuar nga politikanët progresistë në vendet e zhvilluara, të cilët ose urrejnë kombin e tyre ose përpiqen të kompensojnë për elektoratin e humbur – i cili pjesërisht i është bashkuar të djathtës radikale populiste – Duke “importuar” votues të rinj. Në vitet e fundit, nxitur fuqishëm nga kryeministri hungarez Viktor Orban, hebreu amerikano-hungarez George Soros është pare si “gjeniu i së keqes” në këtë konspiracion, si pasqyrë e versionit modern të klasikut antisemitik të Protokolleve të të Urtëve të Sionit.

E ardhmja e Shqipërisë është në duar të atyre që qendrojnë dhe që vendosin. Ata që vendosin duhet të jenë ato njerez, të cilët tani, pas gjithë ketyre ngjarjeve historike, të kenë mesuar nga gabimet e të tjerëve dhe të zhvillojnë zgjidhjet e tyre. Kjo natyrë politike është ajo që përfaqëson një nga idealet e konservatorizmit, i cili mbledh dhe analizon të dhëna për t'i dhënë zgjidhjen më të mirë. Për të mirën e shtetit. Shqipëria ka nevojë për udhëheqje!

Pogradec, 13 korrik 2022

TREGU DHE SIPËRMARRJA SIPAS KONCEPTIT TË DJATHTË



Edison Mehqemeja

Zhvillimi ekonomik dhe politik në Shqipëri këto 9 vitet e fundit të një qeverisjeje të majtë është përkeqësuar dukshëm, aq sa shteti rrezikon të hyjë në një krizë të paprecedent.

Inflacioni i lartë, shoqëruar nga një mungesë totale konkurrueshmërie, për të thithur investime të huaja, dhe sistemi i taksimit - më i larti në rajon, e

kanë rënduar tej mase zhvillimin ekonomik, dhe kanë krijuar një ambjent që nuk incentivon sipërmarrjen, por përkundrazi po shtyn popullatën të emigrojë.

Ky emigrim, në vetvete mbart dy komponentë shumë të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik; krahu i punës, pra të punësuarit aktual, si dhe punonjësit potencial, pasi përqindja më e lartë e atyre që largohen nga Shqipëria sot janë pjesë e rinisë. Po ashtu, komponenti i dytë është “brain drain”, që do të thotë emigrimi i segmentit të krahut të punës, që është tepër i kualifikuar dhe i trajnuar, dhe që shkon drejt drejt një vendi, i cili i ofron të ardhura më të larta për të njëjtën punë. Në këtë pikë, të gjithë familjarizohemi me fenomenin që po ndodh aktualisht në Shqipëri, sidomos në fushën e mjeksisë, ku shteti shqiptar shpenzon nga buxheti i akumuluar nga

taksat e taksapaguesve shqiptar rreth 4 mijë dollarë në vit për të përgatitur një mjek, dhe mjeku i sapo diplomuar, preferon të shkojë drejt Gjermanisë për të punuar dhe ofruar shërbimin e tij. Pra, këtu shteti ka shpërdoruar taksat e shqiptarëve, ka shkaktuar një “opportunity cost”, dhe ka varfëruar tregun e brendshëm mjeksor. Si pasojë, shteti ka dështuar të zhvillojë kapacitetin mjeksor, i cili rrjedhimisht ka pasoja sociale, pasi një shoqëri që nuk garanton një standart të caktuar shëndetsor, nuk ploteson parakushtet minimale për zhvillim të qëndrueshëm.

Pra, duket qartë që kjo qasje e majtë ka dështuar në përmirësimin e jetës së shqiptarëve, po hyn në një rreth vicioz, ku po përseriten të njëjtat gabime me shpresën se do të ketë rezultat të ndryshëm.

Zgjidhja e kësaj situate qëndron pikërisht në alternativën e binomit politik që është qasja e djathtë e politikave zhvilluese.

Politikat e djathta fokusohen në lirinë njerëzore brenda shoqërisë. Minimizimi i roli të shtetit në rendin social dhe ekonomik, janë dy nga pikat kyç të kësaj ideologjie, pasi shteti perceptohet thjeshtë si rregullator me ndikim minimal, dhe funksionin kryesor e ka të krijojë parakushtet për zhvillimin e një ekonomie, e cila bazohet në liritë individuale, në traditë, në ndikim minimal në ekonomi, në promovimin e tregut privat për të arritur mirqënie, dhe në taksa të ulëta.

Shqipëria, aktualisht, me politikat që ndjek ndodhet në polin e kundërt të kësaj qasjeje, dhe si rrjedhojë unë jam i bindur që, nëse në Shqipëri kemi një qeverisje të djathtë, ku roli i shtetit minimizohet, implementohet tregu i lirë, caktohet taksimi i sheshtë, promovohet sipërmarrja, dhe lejohet tregtia e lirë, atëherë Shqipëria do të zhvillohet ekonomikisht, dhe si pasojë dhe shumë plagë shoqërore do të shërohen.

Minimizimi i rolit të shtetit është një nga politikat kryesore që

duhet të implementohen në Shqipëri, në mënyrë që të arrijmë një zhvillim socio-ekonomik të qenësishëm. Aktualisht, kjo qeverisje e majtë e ka pozicionuar shtetin në epiqendër të çdo veprimtarie shoqërore, dhe në Shqipëri me të drejtë është krijuar perceptimi që çdo hallkë shoqërore dhe ekonomike është e ndërvarur nga shteti.

Shteti të jep tapinë e shtëpisë, pra të siguron pronën private, parakusht për një ekonomi të shëndoshë; shteti me bordet përkatese cakton çmimin e naftës, dhe shteti kufizon arbitrarisht mobilizimin e njerëzve.

Prezenca e perceptimit të shtetit si aktori kyç në çdo veprimtari shoqërore, apo transaksion ekonomik dëmton zhvillimin, pasi niveli i korrupsionit është ndoshta më i larti në rajon, çka nënkupton që çdo veprimtari që mund të ndikohet apo diktohet nga shteti, është e veshur me petkun e arbitraritetit. Gjithnjë do të ekzistojë dilemma; nëse një akt i caktuar ku shteti bëhet palë në vendimmarrje, ka një prapavijë të caktuar.

Historia ka treguar që implikimi i shtetit, në shumicën e rasteve ka pasur impakt negativ në zhvillimin ekonomik, pasi vendimmarrja është bazuar në interesa individuale. Pikërisht kjo qasje shtetërore duhet të minimizohet, dhe shteti duhet të ketë rolin e rregullatorit, i cili krijon rregullat e lojës, dhe i lejon aktorëve të ndërveprojnë të lirë me njëri tjetrin.

Një politikë tjetër esenciale për zhvillimin e Shqipërisë, është implementimi i tregut të lirë. Tregu i lirë është ndoshta politika më rezultative, pasi mishëron drejtësinë shoqërore që politikat e djathta na paraqesin.

Tregu i lirë është një sistem ndërveprimi midis aktorëve ku çmimi për produkte dhe shërbime vet-rregullohet nga shitësit dhe blerësit, pa ndërhyrje të jashtme. Në këtë sistem, ligji dhe forcat e ofertës dhe kërkesës janë të përjashtuara nga ndikimet e qeverisë. Nëse një produkt apo shërbim, që hyn

në treg nuk ka pëlqimin e fuqisë blerëse, pra nuk ka kërkesë për atë produkt ose shërbim, atëherë ai produkt apo shërbim së shpejti nuk do të operojë më në atë treg. Ky sistem rrit eficiencën e produkteve dhe shërbimeve. Vetëm produktet dhe shërbimet më produktive dhe esenciale do ndërveprojnë në treg. Qasja e këtij modeli ekonomik në Shqipëri do të kishte rezultate domethënëse për zhvillimin socio-ekonomik, pasi shumë shërbime arkaike, që veprojnë aktualisht do të zhdukeshin nga tregu, dhe vetëm ato më rezultativet do të mbeteshin. Taksimi i sheshtë është një komponent tjetër që do ndikonte në zhvillimin e shtetit shqiptar. Aktualisht Shqipëria ka taksat më të larta në rajon, ku taksat për biznesin e madh janë 15%, ndërsa tatimi mbi të ardhurat gati 20%.

Ky sistem tatimi progresiv rezulton në taksa të akumuluar mbi 30%, dhe automatikisht e rendit Shqipërinë në krye të rajonit për taksa. Por nga ana tjetër Shqipëria ka buxhetin me të varfër, ku aktualisht borxhi publik është gati 80% të PBB.

Kjo inkoherencë midis taksave të larta dhe të ardhurave nga taksat, bazohen në konceptin e “kurbës Laffer”, i cili na shpjegon që ekziston një pikë e artë, ku niveli i caktuar i taksave do të sjelli të ardhurat optimale nga taksimi. Po u kalua kjo pikë, dhe taksat rriten, atëherë të ardhurat nga ato do të pakësohen. Kjo ndodh për arsye se tregjet janë të ndërlidhura dhe shumë të ndjeshme ndaj taksave.

Taksat e larta nuk lejojnë shumë hapësirë që aktorë të rinjë të penetrojnë në treg. Po ashtu dhe aktorët aktual mund të zgjedhin të largohen për kushte tatimore më të favorshme. Gjeja e parë që preket nga një klimë e tillë janë investimet e huaja direkte, dhe aktualisht Shqipëria ka përqindjen më të ulët të investimeve të huaja direkte në rajon, dhe kjo nuk ndodh aksidentalisht, pasi konkureshmëria jonë në rajon është minimale për shkak se Maqedonia dhe Mali i Zi

kanë një sistem taksimi të sheshtë 10%, dhe bizneset e huaja anashkalojnë Shqipërinë për Maqedoninë.

Nëse Shqipëria implementon taksën e sheshtë tek niveli 9-10% dhe taksa kumulative te niveli 15%, atëhere konkurrueshmëria jonë në rajon rritet dhe tejkalon atë të Maqedonisë dhe Malit të Zi. Me një sistem tatimor të ngjashëm, ne kemi avantazh gjeografik, pasi si treg konsumi kemi më shumë se dy fqinjë dhe po ashtu fqinjë tanë përdorin portin tonë të Durrësit për mallrat, ndërkohë që ne kemi si avantazh që evitojmë transport ekstra. Në kushte të tilla një tatim i sheshtë do t'i shërbente më së miri Shqipërisë dhe do të sillte zhvillim ekonomik.

Promovimi i sipërmarrjes dhe kushtet e tregtisë së lirë janë dy shtylla të tjera që do t'i sillnin zhvillim shoqërisë shqiptare.

Sipërmarrja e lirë është shtylla kurrizore e një shoqërie të lire dhe të shëndoshë, në kushtet ku ajo incentivohet që të krijohet falë kushteve fiksale të favorshme dhe tregtisë së lirë të pakushtëzuar nga aktor shtetëror përse i përket kushtëzimit në produkte dhe shërbime. Taksimi i sheshtë, që u permend më sipër krijon kushtet e nevojshme për zhvillimin e sipërmarrjes dhe minimizimi i rolit të shtetit ndikon direkt te kushti thelbësor i tregtisë së lirë.

Shqipëria do të përfitonte teje mase me zhvillimin e këtyre dy shtyllave, pasi potenciali ekonomik i cdo shteti matet nga ritmi i zhvillimit të sipërmarrjeve. Mendoj se situata aktuale në Shqipëri nuk është e favorshme për zhvillimin e nevojshëm ekonomik dhe shoqëror, dhe kjo për shkak të politikave të majta që ndiqen nga qeveria në pushtet.

Zhvillimi i Shqipërisë mund të vijë vetem falë politikave të djathta, të cilat kanë si fokus primar individin dhe fuqizimin e tij brenda shoqërisë. Fuqizimi i individit si rrjedhojë do të avancojë shoqërinë, por kjo do të vijë, vetëm nëse pozitat

individuale ekonomike përmirësohen dhe lejohen të lulëzojnë. Këto pozita mund të përmirësohen vetëm nëse roli i shtetit minimizohet, implementohet tregu i lirë, caktohet taksimi i sheshtë, promovohet sipërmarrja, dhe lejohet tregtia e lirë.

Shqipëria ka nevojë për një mentalitet shoqëror të djathtë, që të tejkalojë konceptin e shtetit patronazhist, vetëm atëhere mund të kemi zhvillimin socio-ekonomik të shumëpritur!

Pogradec, 13 korrik 2022

NEVOJA E SHQIPËRISË PËR MË SHUMË KONSERVATORIZËM



Emanuel Toska

Shqipëria, një vend i vogël në gadishullin Ballkanik me pasuri dhe bukuri të pafundme, është duke u shkatërruar nga keq-qeverisja dhe pangopshmeria e pushtetarëve të sotëm. Janë shumë arsye apo pengesa, që nuk e lënë Shqipërinë të lulëzojë.

Mua, si një i ri shqiptar, kjo situatë ku ndodhet vendi më bënë të revoltohem.

Sipas mendimit tim, Shqipëria ka nevojë për ide dhe vlera të reja, të cilat mund t'i gjejmë tek rrymat e djathta dhe konservatore.

Si fillim, një prej ideve konservatore ka të bëjë me rolin e qeverisë në shoqëri.

Roli i qeverisë duhet të jetë minimal, aq sa vetëm t'u japë garantojë qytetarëve liritë e nevojshme për të ndërtuar, ndjekur dhe arritur synimet dhe objektivat e tyre individuale. Pra, duhet të ketë një rol kuhdestar, por jo diktues! Sot në Shqipëri nuk ndodh kështu, pasi qeveria ka hyrë shume thellë në organizimin e jetës shoqërore dhe rregullave të tregut të lirë dhe nuk e lejon iniciativën private dhe individin të veprojë apo të ecë përpara.

Shumica e njerëzve këtu në Shqipëri, sidomos të rinjtë, kërkojnë të emigrojnë, sepse nuk arrijnë dot objektivat dhe synimet e tyre për jetën. Ata kanë pak shpresa se mund të plotësojnë nevojat e tyre bazike si paga minimale, strehimi, kujdesi shëndetësor etj. Ky dëshpërim dhe tendencë për t'u larguar nga vendi nuk vjen nga paftësia e tyre, por nga keq-qeverisja dhe politikat e saj për rininë. Nëse qeveria nuk ndërhyrë kaq thellësisht në çdo fushë, largimi masiv do të ulet dita ditës, pasi njerëzit do të shohin “dritë në fund të tunelit” nëpërmjet lirisë së tyre ekonomike dhe larg masave shtrënguese qeveritare.

Së dyti, shtresa e mesme në shoqëri është inekzistene. Në ditët e sotme, në Shqipëri ekzistojnë dy ndarje madhore; I pasur dhe I varfër. “I pasur” je, kur behesh servili i pushtetarëve dhe “i varfër” mbetesh, nëse nuk je me pushtetarët dhe punon sa për t'u ushqyer.

Konservatorët janë kundër kësaj situate. Ata janë pro fuqizimit të shtresës së mesme, e cila është motorri i forcimit të ekonomisë publike dhe asaj private. Me një shtresë të mesme të fuqishme ekonomikisht, ku lulëzon sipërmarrja dhe tregu i lirë, vendi mund të ecë përpara.

Së treti, taksat e larta. Taksat e larta në Shqipëri janë duke prekur ekstremet, aq sa pafuqia për t'i paguar ato është kthyer në plagë shoqërore dhe shumë biznese, sidomos të vogla dhe të mesme, kanë shkuar drejt falimentimit. Një grusht biznesmenësh, të ashtuquajtur “oligarkët e qeverisë”, kanë krijuar monopole neo-komuniste të kontrollit të ekonomisë kombëtare, duke prishur në themel kapitalizmin dhe ligjet e tij. Ata u shmangen taksave e tatimeve, bëjnë evasion fiscal dhe kontrabandë, gjithnjë nën mbikqyrjen e qeverisë socialiste, e cila vjel prej tyre mbështetje elektorale dhe pasuri personale. Në anën tjetër, ekonomia e lirë, sipërmarrja e bazuar në tregun e lirë, ndjehet e rrethuar me policinë e kontrolleve financiare dhe gjobat e panumërta. Gjunjëzimi i sektorit të sipërmarrjeve

të vogla e të mesme, ka bërë që ekonomia kombëtare të hyjë në krizë pa kthim. Qeveria merr borxhe për të shlyer borxhe! Praktikisht, jemi në kufijtë e falimentit. Konservatorët janë ata që mund ta ndyrhsojnë situatën, duke nisur nga taksat. Ata besojnë se duhet të ketë taksa të ulëta, në mënyrë që njerëzit të planifikojnë jetesën apo dhe të nxitin zhvillimin e biznesit.

Një pikë tjetër është tregu i lirë, konservatorët mbrojnë kapitalizmin e tregut të lirë, duke besuar se kapitali shpërndahet më mirë pa drejtimin e qeverisë. Konservatorët ekonomikë besojnë se individët dhe bizneset mund t'i përgjigjen më mirë kërkesës së marrësit, sesa një qeveritar, pasi ajo është fushë e tyre, pasi nëse bëjmë një krahasim banal, është njësoj sikurse një volejbollist të luaj futboll apo anasjelltas. Sa më shumë kontroll dhe drejtim qeveritar të ketë ekonomia e lirë, aq më keq është për të.

Konservatorët mbrojnë tregun e lirë, sepse ai nuk ka një humbës apo fitues, por sinergia midis prodhuesit dhe konsumatorit të çon në një marrëveshje me sublime, zhvillim i unitetit dhe krijimtarisë me qëniet njerëzore duke çuar arritjen e një alternative, pra nga fitorja në fitore, ku të gjitha palët si konsumatorët ashtu edhe prodhuesi, por mbi të gjitha dhe vetë shteti, janë përfitues.

Një ndër pikat kryesore dhe shumë e rëndësishme të Konservatorizmit është mbrojtja e traditës, kulturës dhe vazhdimësisë historike. Në ditët e sotme kemi një qeveri majtiste, e cila po shet dhe keqpërdor të gjitha vlerat tona historike e kulturore përmes dhënies së këtyre aseteve me koncensione. Mbrojtja e traditës është diçka shumë e mirë pasi kuptimi i traditës duke njohur historinë e vendit është burimi më i vlefshëm njohës, sepse e vë atë në kontakt të drejtpërdrejtë me shoqërinë. Sot çdo shtet mbron traditat dhe kulturat e tij, pasi është një formë përfaqësimi, por në Shqipëri po ndodh e kundërta dhe, dita - ditës degjojmë për shkatërrimin e kulturës dhe traditës. Po

sjell shembull prishjen e Teatrit Kombëtar, dhënia me konçesion e Butrintit, një ndër vendeve më të rralla dhe të bukura që kemi etj.

Unë jam pro rrymave konservatore për drejtimin e Shqipërisë dhe shumë shteteve të tjera, pasi, sipas mendimit tim, është mënyra më e mirë dhe idetë janë më të mira që një shtet të zhvillohet. Ku ka më mirë të jetosh në një vend të zhvilluar, në të cilin jeton me një ndikim jo të madh të qeverisë dhe të dëgjohet fjala, edhe jo të aplikojmë në E-Albania për të folur .

Pogradec, 13 korrik 2022

LIRIA EKONOMIKE, SI KUSHT PËR DEMOKRACI



Ilda Lekgegaj

Liria ekonomike është kusht i nevojshëm për liri civile dhe politike, të cilat janë faktorë bazë për një demokraci funksionale dhe zhvillim të qëndrueshëm. Demokracia, shpeshherë kërcënohet nga një prej modeleve majtiste, siç është përqëndrimi i vazhdueshëm i pushtetit në duart e qeverisë dhe tendencat e qarta për centralizëm të ekonomisë.

Për të ruajtur demokracinë, fushëveprimi i qeverisë (dhe asaj shqipëtare) duhet të jetë i kufizuar dhe Brenda normave të pranuara. Centralizimi, si formë veprimi edhe pse mund të miratojë programe për transferimin e të ardhurave nga atë pasurit tek më të varfërit, duke reklamuar rritjen e nivelit të jetesës, nuk mund të justifikohet si praktikë e mirëfilltë demokratike. Centralizmi është tendencë përmblylljeje e kufizimi të lirive individuale dhe zgjerim i kufijve veprues të pushtetit qëndror.

Kapitalizmi dhe ekzistenca e lirisë së tregut ofron një lloj balance ndaj pushtetit të centralizuar të shtetit. Natyrisht, nevoja për fuqizimin e tregut të lirë nuk e eliminon nevojën për qeverinë dhe qeverisjen nga një pushtet qëndror me rregulla. Përkundrazi, qeveria është rregullatori thelbësor

dhe njëkohësisht shërben si një forum vendimmarrës për përcaktimin e “rregullave të lojës” apo si një arbitër për të zbatuar rregullat, për të cilat është rënë dakort.

Një tipar tjetër i zhvillimit të shoqërisë demokratike do të jetë sigurisht liria e individëve për të advokuar dhe propaganduar lirshëm për një ndryshim radikal në strukturën e shoqërisë, për sa kohë që advokimi është i kufizuar të bindja dhe nuk përfshin forcën apo forma të tjera shtërngimi.

Por a mund të ushtrohet liria për të advokuar në një shoqëri socialiste? Jo. Në mënyrë që njeriu të advokojë për ndonjë gjë, ai duhet, para se gjithash të jetë në gjendje të sigurojë jetesën. Por kjo sakaq ngre një problem në shoqërinë socialiste, për shkak se të gjitha vendet e punës janë nën kontrollin e drejtëpërdrejtë të autoriteteve politike. Ndërsa në një Shqipëri kapitaliste, për të nisur një ide është e nevojshme thjeshtë të bindësh investitorët për të marrë fondet e nevojshme, duke sjellë zhvillim dhe liri.

Tarifat dhe kufizimet e tjera në tregtinë ndërkombëtare, ngarkesa e lartë me taksa dhe struktura komplekse dhe e pabarabartë e taksave, komisionet rregullatore, kontrollet qeveritare mbi çmimet dhe pagat dhe një numër masash të tjera, u japin individëve një incentive që të keqpërdorin dhe keqdrejtojnë burimet dhe të çrregullojnë investimin e kursimeve të reja. Ajo për të cilën kemi nevojë urgjente për stabilitetin ekonomik dhe për zhvillim, është një reduktim i ndërhyrjeve të qeverisë.

Është e domosdoshme që qeverinë ta përdorim për të siguruar një kuadër monetar të qendrueshëm. Është e dëshirueshme, gjithashtu që ne të përdorim qeverinë si mekanizëm të përgjithshëm ligjor dhe ekonomik, i cili u mundëson individëve të prodhojnë rritje në ekonomi. Fushat madhore të politikës qeverisëse të një Shqipërie kapitaliste, që janë të rëndësishme


për stabilitetin ekonomik, janë politikat monetare, politika fiskale dhe politika buxhetore.

A është një rastësi, që kaq shumë nga reformat qeverisëse të dekadave të fundit kanë shkuar shtrembër? Apo kjo është thjesht për shkak se programet janë difektoze në detajet e tyre? Unë besoj se përgjigjia është qartazi, jo. Defekti qendror i këtyre masave është se ata kërkojnë që, përmes qeverisë të detyrojnë njerëzit të veprojnë kundër interesave të veta. Një shembull është tatimi mbi të ardhurat. Fillimishit ky tatim u vendos me norma të ulëta dhe më vonë na mbërtheu si një mjet për të shpërndarë të ardhurat në favor të klasave të ulëta, e cila mbulon vrimat fiskale dhe është gjerësisht joefikase në realitet. Një taksë e sheshtë mund të japi po aq të ardhura sa dhe ajo progresive që zbatohet aktualisht. Një tatim mbi të ardhurat, që synon të reduktojë pabarazinë dhe të promovojë shpërndarjen e pasurisë në praktikë, ka ushqyer riinvestimin e fitimeve korporative, rrjedhimisht duke favorizuar rritjen e korporatave të mëdha, duke penguar funksionimin e tregut të kapitalit dhe duke dekurajuar themelimin e sipërmarrjeve të reja.

Shqipëria ka shumë shkatërrime si komb. Megjithatë struktura e vlerave të djathta do t'i bëjë ballë kësaj. Unë besoj se do të jemi në gjendje të zhvillojmë Shqipërinë. Por ne mund ta bëjmë këtë, nëse bindim bashkëkombësit tanë se institucionet e lira dhe politikat e djathta ofrojnë një rrugë të sigurt, ndonëse me raste edhe më të ngadaltë drejt qëllimeve të përbashkëta në krahasim me pushtetin e përqendruar të shtetit.

Pogradec, 13 korrik 2022

IDEOLOGJIA E DJATHTË LIBERAL-KONSERVATORE



Ina Metalia

Shoqëria jonë ka kaluar në disa etapa zhvillimi. Kanë qenë të shumtë mendimtarët politik si dhe ka patur shkolla të ndryshme mendimi, të cilat/cilët e interpretojnë realitetin botëror dhe në të njëjtën kohë, kanë qenë e janë në kërkim të një shoqërie ideale që krijon kushtet optimale për krijimin e një sistemi politik, që garanton bashkëjetesën e gjithësecilit dhe rritjen e cilësisë së jetës.

Shqipëria, një vend i vogël por me një histori tepër komplekse, ka përjetuar regjime të ndryshme politike, ku edhe pasojat negative nuk kanë qenë të pakta. Për shkak se kemi ardhur nga një regjim totalitar 45-vjeçar, ndërtimi i një shoqëri plurariste e Demokratike mbetet ende një nga sfidat më të mëdha të vendit tonë.

Shoqëria në vetvete, është një organizim njerëzor që sjell si rrjedhojë plotësimin e disa nevojave bazike të domosdoshme për jetën. Mendoj se ne lindim në një shoqëri të caktuar dhe i mësojmë gjërat ashtu siç shoqëria na i servir. Që do të thotë; nuk e krijon njeriu shoqërinë, por shoqëria njeriun!

Megjithatë, racionaliteti nënvizon: “Pavarësisht se unë lind në kushte që nuk i kam përcaktuar vetë, në një fazë të caktuar unë mund t’i ndryshoj këto kushte, duke marrë në dorë jetën time e të mos rri pasiv”. Individidi është pjesë thelbësore e një shoqërie, nga ku gjithçka merr formë dhe individit e merr plotësisht kuptimin e tij të vërtetë, kur mendon, sillet dhe vepron si i tillë, dhe fillon e bëhet aktiv.

Shoqëria është deri diku kontradiktore. Edmund Burke, një konservator Anglez i post-revolucionit Francez, mendonte se, shteti nuk mund të jetë ortakeri, por është një partneritet, një bashkëveprim i barabartë brezash. Shteti është një partneritet disi mistik, pasi nuk është një partneritet vetëm midis qenieve; meqenëse vjen si prodhim i të shkuarës, është partneritet edhe me qeniet që nuk jetojnë më, po aq sa është një partneritet dhe me ata që nuk kanë lindur ende. Pra shteti nuk mund të ndërtohet duke marrë për bazë vetëm të tashmen, por duhet të jetë një vazhdimësi brezash. Të jesh konservator, nuk do të thotë që i frikësohesh të “re”-së; ajo çfarë konservatorët i frikësohen janë situatat e reja pa shoqëri dhe insitucione (anarki), që i bën ata disi Platonian në këtë pikë.

Vizioni im për të ardhmen e vendit tonë, është që të jetë një vend me një sistem demokratik solid, ku garantohen të drejtat themelore të njeriut, mirëqenia e tij dhe ku mbizotëron forca e ligjit. Pra, një shoqëri e zhvilluar, e lirë e dhe e drejtë. Në bindjet e mia, një shoqëri me një ideologji të djathtë liberal-konservatore, i mishëron më së miri këto pikpamje. Megjithatë, në qasjen time të kundërtat nuk i shoh si përjashtimore, por si përpjestimore mes tyre. Që do të thotë, asgjë nuk duhet të jetë radikale dhe çdo ideologji duhet t’i vijë në funksion shoqërisë dhe jo e anasjellta.

Por çfarë është një shoqëri demokratike dhe e djathtë?

Një vend demokratik është, së pari një shoqëri ku konkretizohen një sërë lirishë. John Stuart Mill, një nga perfaqësuesit më të spikatur të liberalizmit klasik, shprehet se Liria është vlera kryesore politike dhe e ndan atë në disa kategori, në lirinë e shprehjes së mendimit, lirinë e bashkëpunimit e shoqërimit me të tjerët, si dhe liria e ndertimit të jetes sipas planeve vetjake. Mohimi i lirisë së shprehjes mbart rrezikun e despotizmit të zakonit.

Një shoqëri demokratike me përfaqësim dhe e djathtë, për mua nënkupton gjithashtu një shoqëri që sillet rreth parimit të shumicës, megjithatë e kufizuar nga ndarja dhe drejtëpeshimi i pushteteve. Që një shoqëri të funksionojë mirë, duhet të ketë një ndarje të qartë të pushteteve të saj ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Kjo ndarje lehtëson detyrat institucionale duke shfrytëzuar më së miri përparësitë e tyre.

Shqipëria, duhet të jetë një vend që perqafon zhvillimin, duke mos lënë në harresë traditën dhe vlerat shoqërore, duke respektuar kështu dhe një rend hierarkik të ushtrimit të pushtetit. Me rëndësi të veçantë shoh evolucionin duke i shkuar për shtat ndryshimeve sociale dhe përshtatur njëkohësisht me problematikat bashkëkohore, megjithatë, duke mos lënë asnjëherë në harresë historinë tonë dhe bindjet anti-totalitariste-komuniste.

Vendi ynë duhet të të garantojë lirinë dhe të drejtën për të votuar i lirë; për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur pa ndikimin e faktorëve të tjerë. Garantimi i mos-cënimit të kësaj të drejte themelore, është parakusht për një Shqipëri demokratike! Mungesa e votës së lirë, devijimi, deformimi, manipulimi dhe tjetërsimi i votës së shqiptarëve në këto 10 vitet e fundit, ka deformuar bazën mbi të cilën ngrihen institucionet demokratike, vetë demokracia shqiptare! Pa rikthimin e votës së lirë, nuk ka korrigjim të demokracisë në asnjë formë të saj. Zhvlerësimi i votës nëpërmjet blerjes dhe manipulimit të

saj, ka sjellë si pasojë zgjerimin e masës së votuesve që nuk preferojnë të marrin pjesë në votime!

Përqafimi i vlerave evropiane dhe zbatimi i tyre deri në instancën më të fundit, është kahu i duhur për Shqipërinë. Këto vlera fillojnë që nga liritë themelore, kur kuptojmë rëndësinë e të qenurit individ, lirinë e të drejtën e pronës, ligji dhe rëndësia e zbatimit të tij, ruajtja e identitetit dhe mos lënia në harresë e historisë dhe prejardhjes tonë.

Duke përmendur parimet politike për një shtet demokratik të së drejtës, nuk duhet të lemë pa përmendur aspektin ekonomik. Shqipëria si një vend demokratik e i djathtë, duhet të ndërtohet mbi bazat e ekonomisë së tregut të lire, ku shteti duhet të ruaj një rol minimal (Dora e fshehur e shtetit, sipas Adam Smith). Shteti duhet të garantojë rregulla të barabarta dhe konkurrencën e lirë të tregut dhe të kryejë funksionin e një rregullatori të paanshëm.


Për ta përmbledhur, Shqipëria, si një vend i vogël Ballkanik, që ka kaluar mes shumë trazirash socio-ekonomiko-politike, ka një rrugëtim të gjatë e plot sfida drejt ndërtimit të një demokracie të konsoliduar. Për sa kohë në thelb qëndron individi, vlerat nacionale, besimi në antikomunizem dhe anti-totalitarizem, ku mbi të gjitha prevalojnë të drejtat themelore të individit (e fjalës, e jetës, e pronës, e arsimimit etj), ku kryefjala bie mbi forcën e ligjit dhe ku garantohej një konkurrencë e lirë në ekonominë e tregut, atëherë mund të themi se jemi në rrugën e duhur. Që të realizohen të gjitha këto, kërkohet një vullnet popullor dhe politik, bazuar tek interesi kombëtar dhe parimet e liberal-konservatorizmit.

Unë besoj fort, që të gjithë duhet të fillojmë ndryshimin nga vetja dhe të kontribuojmë për një sistem demokratik e të djathtë, që do çojnë në një Shqipëri të zhvilluar dhe Evropiane. Ndaj askush prej nesh, si qytetar shqipëtar, nuk duhet të harroj

detyrimet e tij dhe rolin që ka në çuarjen përpara të këtyre parimeve dhe realizimin e tyre.

Pogradec, 13 korrik 2022

VIJAT IDEOLOGJIKE MES PARTIVE KRYESORE NË SHQIPËRI



Irista Çupa

Dallimet ideologjike mes dy partive politike kryesore në Shqipërinë e 2022 vazhdojnë të mbeten të vështira për t'u identifikuar. Për të analizuar shkaqet që kanë sjellë në këtë dukuri, do të nëvojitej kohë, eksperiencë politike dhe një vështirim i hollësishëm i arsyeve dhe mosarsyeve që i kanë çuar përfaqësuesit e të djathtës dhe të majtës

në ruajtjen, injorimin apo përdorimin e politikave të caktuara, pa patur rëndësi dallimi thelbësor ideologjik të saj.

Duke ju përmbajtur tematikës (idetë e djathta për zhvillimin e Shqipërisë), por pa dashur të lë mënjanë as këndvështrimin tim mbi këtë realitet, do të thoja se prirem të bësoj se, për të zgjidhur një dallim të tillë, problemin duhet ta kërkojmë në gjenezë, të cilën unë kam zgjedhur ta shoh që pas përmbytjes së komunizmit në Shqipëri dhe përballjen e menjëhershme me një sistem utopik, për realitetin e kohës, siç ishte demokracia.

Kalimi nga një sistem, ku prej pothuajse gjysëm shekulli, elita ishte e shtypur, prona i përkiste shtetit, ekonomia i përkiste shtetit, dhuna ishte e ligjshme dhe gjithçka vërtitej rreth barazisë në mjerim, ishte një kapërcim përtej çdo mundësie

dhe kapaciteti real në një demokraci funksionale. Thënë kjo, për shkak se ata të rinj, që shërbyen si shkëndijat kryesore, që nxitën ardhjen e demokracisë, ishin po ata të rinj, shumica prej të cilëve ishin të indoktrinuar nga mekanizma të pamëshirshme të ndikimit të parties - shtet në shoqëri. Megjithatë, koha politike e rënies së komunizmit ishte në harmoni dhe sinkron me zhvillime të ngjashme në arenën ndërkombëtare dhe si e tillë, Shqipëria ishte e destinuar për një kalim të tillë, me të gjitha kostot dhe përfitimet e saj.

Falë Zotit, ekziston e djathta!

Kjo e fundit, ka lindur dhe ka ekzistuar shumë kohë përpara ardhjes së demokracisë në Shqipëri dhe si e tillë, gjithçka na nevojitej 32 vite më parë dhe na nevojitet dhe sot ne, është adaptimi dhe zbatimi i politikës së djathtë, në funksion të shtetit dhe në shërbim të qytetarëve. Do të mund t'i prekja të gjitha pikat kryesore të një politike të djathtë të bërë keq apo të pa realizuar në Shqipëri, por për këtë modestisht e them se do të duheshin vite experiencë dhe prekje nga afër e realitetit në institucione dhe në ushtrimin e politikave konkrete.

Megjithatë, do të doja të ndaja një pjesë prej tyre, të cilat kam bindjen se do t'i jepnin frymëmarrje mirëfunksionimit të shtetit në Shqipëri.

Taksa e sheshtë; një normë tatimore, e cila vlen për të gjithë pavarësisht të ardhurave. Kjo taksë do të sillte zhvillimin e biznesit dhe krijimin e një shtrese të mesme të mirëfilltë nga ku, do të nxitet investimi në biznese të medha, duke krijuar më shumë vende pune, rritur të ardhurat dhe forcuar ekonominë.

Qarkullimi i elitave do të bëhej i paevitueshëm dhe si i tillë do të sillte mirëqenie, por edhe pozicionim të individëve në shoqëri, sipas një rendi të caktuar dhe një pabarazie të paevitueshme, për sa kohë çdo njeri është i ndryshëm dhe unik.


E djathta beson se ekziston një ligj natyror, që shërben si rregullator dhe udhëheqës të jetës si pjesë e universit, ligj ky i paracaktuar nga Zoti. Përpara diktaturës së proletariatit të Enver Hoxhës, në gjykimin tim kishte premisa për një Shqipëri më të mirë, por diktatura i rrënoi të gjitha, duke u nisur nga goditja e besimit në Zot. Pushtimi Osman, konvertimi i fesë për shkak të luftrave, zhdukja e institucioneve fetare nga komunizmi dhe më pas, rikthimi i lirisë së besimit në demokraci, na kanë ofruar mundësinë e zgjedhjes dhe ushtrimit të fesë në liri. Megjithatë, mendoj se besimi në Zot dhe praktikimi i tij nëpërmjet fesë që beson, është një mekanizëm i suksesshëm rregullator, që garanton një shoqëri që bazohet në vlera. Për arsytet e mësipërme, në gjykimin tim, liria e besimit në fe, do të duhej të ishte e kanalizuar, e kontrolluar dhe e pasur në informacion për të rritur një shoqëri të ndërgjegjësuar për vlerat thelbësore, që përcillen nëpërmjet fesë.

Nga ana tjetër, një shoqëri e arsimuar është një shoqëri, e cila siguron të ardhmen e sigurt të një vendi. Megjithatë, aftësitë dhe kapacitetet qëndrojnë gjithnjë në rrafshin personal. Shteti e ka për detyrë të ofrojë barazi në mundësi, por ecuria e individit dhe nxitja e konkurrencës në të gjitha fushat e jetës, krijon individë të lirë, të formuar dhe të gatshëm për të ndërtuar të ardhmen e një shteti.

“Të drejtat e njeriut, janë qëllimi”. Laissez-faire në ekonomi, ruajtja e traditës, ruajtja e pronës, forcimi i institucioneve shtetërore, ndarja e pushteteve, liria e mendimit, liria e fjalës, taksa të ulëta dhe ndërhyrja sa më e vogël e shtetit në jetën e individit, patriotizmi; janë origjina, zhvillimi dhe destinacioni i një politike të djathtë të suksesshme, e cila në thelb, besoj se ka në qendër ruajtjen e një rendi natyror me në qendër individin dhe lirinë e tij për të qenë vetja, në harmoni vazhdimësinë e traditës dhe principeve themelore.

Pogradec, 13 korrik 2022

PËR RIKTHIMIN TEK REPUBLIKA PARLAMENTARE



Iva Hasko

Demokracia (gr. *demo* - popull, *kraci* - rend) është një formë qeverisjeje, në të cilën shumica e njerëzve ushtrojnë sovranitetin e tyre ose drejtëpërdrejtë, nëpërmjet referendumeve, ose në mënyrë jo të drejtëpërdrejtë, nëpërmjet zgjedhjes së përfaqësuesve të tyre. Demokracia është, para së gjithash çështje e pushtetit: e përdorimit,

ndarjes, kontrollit të pushtetit, ose përgjegjësia e atyre që e ushtrojnë ose kërkojnë ta ushtrojnë atë.

Jeta jonë është e ndikuar pashmangshëm dhe në mënyra të ndryshme nga politika dhe (mos)rezultatet e saj. Kështu, politika ndikon e rregullon sigurinë, shëndetin, shkollimin, banimin, komunikacionin, mirëqenien, ngrohjen, ujin e pijshëm, kushtet ekonomike, ndriçimin publik, drejtësinë si dhe çdo fushë e aspekt të jetës sonë të përditshme, si asaj individuale ashtu edhe shoqërore. Meqenëse rrethohemi nga politikat publike, dhe në masë të madhe varemi nga synimet, cilësia, mjetet dhe veprimet e politikës, të kuptuarit e politikbërjes është premisa për analizimin e proceseve, vendimeve dhe rezultateve të politikave publike.

Një ndër problemet më thelbësore, që e përcjell njerëzimin me shekuj të tërë, ishte dhe mbetet, çështja e organizimit politik, social e ekonomik, pra me një fjalë, qeverisja. Politika, si pjesë përbërëse dhe e pandashme e jetës kolektive, konsiston në njerëz dhe lëvizje shoqërore, që dalin përtej nevojave të tyre personale dhe interesave të ngushta ekzistenciale. Kjo me synim parësor për të krijuar një botë më të hapur dhe të lirë, ku secili mund të paraqitet me kërkesat dhe specifikat e tij individuale e kolektive, si dhe me qëllim të organizimit dhe krijimit të sigurisë e mirëqenies së gjithëmbarshme shoqërore. Plotësimi i nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, si dhe krijimi i kushteve më të përshtatshme jetësore, është në thelb vetë arsyeja e ekzistencës së veprimtarisë politike.

Vizioni im personal për zhvillimin e demokracisë në vendin tonë në të ardhmen e afërt, do të përfshinte qeverisjen kushtetuese, një shtet kushtetues dhe një kthim në republikën parlamentare, ku deputetët zgjidhen nga populli dhe jo të emërohen nga kryetarët e partive.

“Qeveria e popullit, nga populli, për popullin”

Demokracia jonë është një sistem parlamentar, që duhet të jetë produkt dhe të ketë përfaqësues, të zgjedhur me votën e qytetarëve dhe jo me përzgjedhje të kontrolluar politike.

Parlamenti duhet të ushtrojë autoritetin e plotë që buron nga e drejta e tij kushtetuese në ligjbërjen dhe kontrollin e pushtetit ekzekutiv të qeverisë. Parlamenti duhet të ketë autonominë e tij financiare dhe strukturat e veta, që funksionojnë me kapacitet të plotë për t'i shërbyer çdo deputeti dhe grupimi politik në mënyrë të barabartë.

Zgjedhjet e ndershme, janë guri i themelit të një qeverie të përfaqësuar. Shqipëria po kalon një nga periudhat më të errëta në historinë e saj të parlamentarizmit. Demokracia shqiptare është në një rrezik të madh, për shkak të krimit të organizuar

dhe trafikimit të lidhur me të. Qeveria dhe paratë e krijuara nga këto aktivitete të jashtligjshme, synojnë, jo vetëm ndikimin në zgjedhje, por kontrollin dhe pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në institucionet vendimmarrëse, siç është edhe parlamenti.

Korrupsioni qeveritar, i lidhur me krimin e organizuar po shkatërron demokracinë, ekonominë, të drejtat individuale dhe besimin e popullit shqiptar se qeveria është në shërbim të popullit. Prandaj, ne duhet të shikojmë nga e ardhmja me synim përfshirjen tonë në politikbërje aty ku mundemi, duke mbrojtur fort parimet bazë të demokracisë dhe së djathtës konservatore.

Pogradec, 13 korrik 2022

PËR NJË PARTI REALE ME VLERA KONSERVATORE



Izmir Xhafa

Nga viti 1990 deri më sot, dy partitë politike kryesore në vend janë Partia Demokratike dhe Partia Socialiste. Partia Socialiste u “krijua” nga ndryshimi i emrit të Partisë Punës, gjatë ndryshimit të sitemit dhe për këtë arsye është një parti e majtë, ndërsa Partia Demokratike u krijua si parti anti komuniste dhe si e tillë do të ishte një parti e djathtë. Pavarësisht rrymave ideologjike të ndryshme, të dyja këto parti, gjatë 32 viteve vetëm kanë bërë rotacion qeverisës, pa aplikuar vlerat apo ideologjitë politike mbi të cilat ato janë ngritur apo që përfaqësojnë formalisht. Pasojat e kësaj historie, pa dyshim që i ka vuajtur Shqipëria.

Edhe pse Partia Socialiste është partia që ka udhëhequr për më shumë kohë vendin, Partisë Demokratike, kur i është dhënë mundësia nuk ka arritur ta përmbushë kurrë qëllimin e saj për të cilin u themelua. Le të përmendim disa nga anashkalimet që PD i ka bërë filozofisë së saj politike, gjatë kohës që ka qeverisur vendin.

PD dhe aleatët e saj në koalicion, nuk ua ktheu pronat shqiptarëve. Ajo nuk i ndëshkoi komunistët dhe zyrtarët e përfshirë në sistemin e ndëshkimeve që jepte regjimi diktatorial siç ishin internimet, dhuna në kampe pune dhe burgje, vrasjet me dhe pa gjyq etj. PD anashkaloi gjykimin e këtyre krimeve, me ndonjë përjashtim dhe ndërhyrje jot ë fortë ligjore. Të gjitha këto lëshime e çuan atë në një krizë të thellë identiteti, në të cilën ndodhet edhe sot e që nuk po arrin dot që të vijë në pushtet. PD harroi që erdhi në skenë si parti anti-komuniste, e cila duhej të bënte reformat ë djathta dhe jo të unifikohej gradualisht me programin e rivalet historike, punistëve socialistë, aq sa sot, e kemi të vështirë të dallojmë kufirin mes tyre.

E djathta në Shqipëri, edhe pse ka kaluar shumë sfida e humbje gjithë këto kohë, përsëri vazhdon të mos kthehet te vlerat e saj, por vijon akoma me të njëjtën mënyrë konformizmi dhe pragmatizmi. Problemet që ka ajo, tashmë dihen dhe janë kollaj te evidentueshme, sepse një pjesë e tyre janë të trashëguara. Problemi tashmë nuk është evidentimi i tyre, por nevoja që ka vendi ynë për një parti të djathtë konservatore, e cila të pasqyrojë të gjitha vlerat e saj në vend.

Aktualisht Shqipëria është në një krizë ekonomike, sociale dhe shoqërore. Ajo ka nevojë për një taksim më të ulët për të ardhurat e qytetarëve, që garanton një mirëqenie më të mirë të tyre, ulje të taksave për biznesin e vogël, rikthimin e taksës së sheshtë, përgatitja e infrastrukturës për zhvillimin e qëndrueshëm të bizneseve të mëdha që do të sillte rritje të punësimit, zhvillimi i arsimit të ulët, të mesëm dhe të lartë, investimi në shkencë, rritje të pensioneve etj. Gjithashtu, një nevojë tjetër e menjëhershme është rikthimi i barazisë, meritokracisë, konkurrencës dhe krijimi i shtresës së mesme, që tashmë pothuajse nuk ekziston fare.

Një shtresë e mesme shoqërore e fuqishme nënkupton më pak korrupsion, institucione më të forta, drejtësi, mirëqenie dhe zgjedhje të lira etj.

Shqiptarët, prej vitesh tashmë po emigrojnë jashtë vendit në përmasa massive, sidomos të rinjtë. Ky është një fenomen që duhet ndalur menjëherë, ndaj dhe aplikimi i politikave konservatore të patriotizmit dhe atdhedashurisë është shumë i nevojshëm. Kjo politikë duhet të konservohet tek fëmijët që në moshë të vogël. Por qeveritë e djathta, duhet të krijojnë programe dhe projekte konkrete për mbështetjen e të rinjve në sipërmarrje, edukim, trajnim profesional, strehim, kujdes shëndetësor për familjet e reja etj.


Të tjera shtylla të së djathtës janë familja dhe tradita.

Familja kohët e fundit po përjeton situata shumë të vështira, për shkak të politikave të majta, që janë ndjekur. Numri i divorceve është rritur, shumë çifte të reja e kanë të vështirë të krijojnë familje, për shkak të gjendjes ekonomike dhe mos ndihmës nga shteti. Familja sipas së djathtës është burimi kryesor i vlerave morale; aty është vendi ku dalin qytetarët të përgjegjshëm.

Pra, edhe pse gjatë gjithë këtyre viteve nuk kemi patur një parti të djathtë, që të ketë aplikuar vlerat dhe virtytet e së djathtës reale. Vendi ynë ka mundësi për ta bërë këtë gjë, mjafton vetëm vullneti i atyre që e duan me të vërtetë atë, sepse nga eksperiencia e shumë vendeve europiane është e faktuar tashmë, që politikat e djathta konservatore kanë qenë gjithmonë efikase dhe kanë zhvilluar ekonominë dhe shoqëritë e tyre.

Pogradec, 13 korrik 2022

TEZAT E DJATHTA NË SHQIPËRI



Kejsi Tola

Pas një zbehje të dallimeve ideologjike mes partive politike pas vitit 1990 u shfaq një diskurs i ri në qendër të të cilit u vendos efikasiteti, pragmatizmi, teknokracia etj. Shqipëria gjatë këtyre 27 viteve pluralizëm e ka patur të theksuar në disa drejtime dallimin e majtë-e djathtë dhe në disa drejtime as që ka patur fare dallime. Kjo ka ardhur

për shkak të faktit që partitë kryesore janë krijuar në rrethana jo aq të natyrshme. Partia Socialiste u krijua nga ndryshimi i emrit të Partisë së Punës që kishte drejtuar e vetme vendin për 45 vjet duke shkaktuar një gjëmë kombëtare me shtetin totalitar që ndërtoi dhe Partia Demokratike u krijua si një parti që donte demokracinë dhe ishte kundër komunizmit.

Çfarë është e djathta, nga ku buron premisa që çon tek ajo, çfarë përfaqëson dhe çfarë synon e djathta? E djathta beson se një ligj natyror rregullon jetën e njeriut, shoqërisë dhe botës. Nën ndriçimin e këtij ligj natyror e djathta kupton qëllimin apo detyrat e qeverisë (me qeveri kuptojnë të gjitha degët e saj si ekzekutivi, ligjvënësi dhe gjyqësori) dhe kuptimin e tërë humanitetit tonë. Ligji natyror për të djathtën fillon me

“idenë e një rendi natyror”. Ky rend natyror është zbuluar apo zbulohet nga njeriu por nuk krijohet prej tij. Ky rend natyror i jep trajtë dhe kufizon kuptimin e lirisë. Ky rend natyror i orienton njerëzit drejt një hierarkie natyrale të qëllimeve njerëzore. Këto qëllime, që janë familjare (kanë të bëjnë me familjen), politike, filozofike dhe teologjike, janë të përbashkëta për çdo njeri. Për idenë e djathtë qëllimi më i lartë është ai i zbulimit të së vërtetës mbi natyrën dhe hyjësinë e Zotit. Ky qëllim domosdoshmërisht e bën njeriun të jetë një qenie me të drejta individuale të kufizuara.

Nga kjo pikëpamje e djathta mendon se njerëzit, siç thuhet në Deklaratën e Pavarësisë së SHBA-së, “janë krijuar të barabartë nga Zoti dhe janë të pajisur nga Ai me disa të drejta të patjetërsueshme”. Kur themi janë krijuar të barabartë nuk do të thotë se njerëzit janë njësoj, përkundrazi çdo njeri është një krijesë unike. Këtu lind një nga tiparet apo shfaqet një nga rrënjët bazë të së djathtës: kuptimi që ajo ka për natyrën njerëzore.

E djathta, duke menduar se njerëzit janë unikë dhe të krijuar nga Zoti, mendon se ekziston një natyrë njerëzore e cila është e pandryshueshme. Duke qenë se njeriu ka një natyrë njerëzore e cila nuk ndryshon atëherë e djathta mendon se njeriu është mëkatar, është një qenie e dobët e cila nuk ka për qëllim të ndryshojë botën por ka për detyrë të luftojë me veten në mënyrë që duke rregulluar të rregullojë shoqërinë. Kësisoj e djathta vlerëson përunjësinë, është kundër epshit për pushtet, është kundër përdorimit të çdo mjeti për të arritur qëllimin. Ideja e djathtë që thotë se njeriu ka një natyrë të tijën të pandryshueshme, çoi në propozimin politik të djathtë për një shtet të vogël që ndërhyr pak në jetët e njerëzve, që mbron liritë dhe të drejtat themelore, që përkrah iniciativën e individit, që mbledh pak taksa, që nuk i mëson njerëzit se çfarë duhet të bëjnë, që nuk i çon njerëzit me zor në shkolla shtetërore, që nuk ka fare madje shkolla shtetërore etj. Një


shtet i djathtë nuk përpiket të ndryshojë natyrën e njeriut dhe as njeriun.

Parimet e djathta kanë të bëjnë me nacionalizmin, ndërsa të majtët me internacionalizmin; të djathtët parapëlqejnë vlerat konservatore, ndërsa të majtët më shumë parapëlqejnë ndryshimin e tyre; të djathtët pëlqejnë një rol shumë më të vogël të shtetit e më të madh të individit, të majtët të kundërtën. Për të djathtët, sa më i vogël shteti, aq më funksional është ai. P.sh.: a është më mirë që me parat tona të bëjmë vet çfarë të dëshirojmë, por në rast se mbetemi keq nuk mund të kërkojmë ndihmë nga shteti (e djathta), apo nëse do të paguajmë taksa më të larta, që do të thotë se qeverisë i japim në dispozicion një shumë jo të vogël të parave për t'i menaxhuar dhe pastaj ajo siguron një shpërndarje sa më të barabartë, e cila është e mundur për të gjithë (e majtë), duke përfshirë këtu edhe të papunët.

Ajo që është për t'u çuditur që globalizmi po gjen armiq të tollovitur dhe në Shqipërinë e vogël, por po anatemohet hapur liberalizmi dhe të gjitha gjërat që lidhen me të. Çuditërisht kjo ideologji e stisur tek ne nuk flet shumë për tradicionalizmin bazë nga ku ushqehet konservatorizmi, pasi historia politike e vendit tonë është relativisht e kufizuar, e lokalizuar më së shumti pas viteve '90, teksa dy partitë themelore të viteve '20 të shekullit të shkuar, as nuk arritën formësimin e një identiteti ideologjik. Nga ana tjetër, një qasje reale me tradicionalizmin, që do të ishte perceptimi dhe roli i duhur i monarkisë pothuaj është i pamundur me kushtet e vendit dhe trashëgiminë e saj. Pak forca të tilla politike të Djathta, që mund ta artikulonin atë në mjedisin politik shqiptar as arrijnë ta kuptojnë qoftë edhe në termat më të thjeshtë.

Pogradec, 13 korrik 2022

SI DUHET TË JETË NJË QEVERISJE E DJATHTË



Lukas Heidorn

Unë besoj se në një qeverisje të djathtë, ne duhet të kemi sa më shumë treg të lirë dhe aq ndërhyrje shtetërore sa të jetë e domosdoshme. Shqipëria ka qenë një nga rastet ekstreme të komunizmit në botë, e krahasueshme vetëm me Korenë e Veriut. Prandaj, si shoqëri ne kemi përjetuar nga afër pasojat negative të vazhdueshme të kontrollit shtetëror dhe qeverisjes së centralizuar dhe nuk duhet të ushqejmë iluzione për dështimin e një qeverisje të centralizuar.

Unë jam rritur duke dëgjuar histori për varfërinë ekstreme gjatë komunizmit nga familja ime dhe ndryshimet dramatike në cilësinë e jetës që përjetuan, pasi komunizmi ra. Unë po ashtu i përkas një familjeje sipërmarrësish dhe e kam kuptuar nëpërmjet të afërmeve të mi, se disa sektorë privatë që janë plotësisht të parregulluar janë jashtëzakonisht të suksesshëm dhe ata që përballen me ndërhyrjen e qeverisë janë në gjendje të keqe.

Një nga arsyet pse jam antarësuar në Partinë Demokratike të Shqipërisë ka qenë fakti se është një parti e djathtë, që promovon të drejtat individuale dhe zbaton ekonominë e

tregut. Kur partia ime ishte në pushtet, Shqipëria konsiderohej si krye reformatore nga Banka Botërore. Në fakt, sipas raportit të të bërit biznes, Shqipëria e përmirësoi ndjeshëm pozicionin në nivel ndërkombëtar, për sa i përket klimës së biznesit, falë drejtimit të Partisë Demokratike.

Si parti politike, ne ndërmorëm gjithashtu disa nga reformat më të vështira dhe më të guximshme të privatizimit, duke hequr qafe kompanitë e shumta shtetërore, të cilat thjesht po shpërdoronin paratë e taksapaguesve.

Fatkeqësisht, tani që jemi në opozitë, të gjitha proceset e liberalizimit të tregut janë ndalur plotësisht dhe qeveria aktuale socialiste thjesht po rrit ndërhyrjet, rrit subvencionet dhe zgjeron rregullat. Kur të kthehemi në pushtet, ne duhet të godasim monopolet e lidhura me politikën dhe të rikthejmë konkurrencën e lirë në treg.

Me pak fjalë, unë besoj në një qeveri e djathtë duhet të jetë e vogël që kujdeset kryesisht për sigurinë, sundimin e ligjit dhe ruajtjen e të drejtave individuale. Këtu dua të shtoj, se një nga mësimet themelore të nxjerra në historinë njerëzore është se e ligjet e tepërta të shtetit kanë një efekt kundërproduktiv. Kjo është arsyeja pse mijëra vjet më parë Ciceroni thoshte “sa më shumë ligje, aq më pak drejtësi”, ndërsa Taciti thoshte “se sa më i korruptuar të jetë shteti, aq më të shumta janë ligjet”.

Qeveria e djathtë, kur të vijë në pushtet, duhet të orientohet drejt derregullimit, që do të thotë të eliminohen të gjitha ligjet e panevojshme dhe fokusimi në rolet bazë të qeverisë dhe duhet të fokusohet në respektimin dhe zbatimin e ligjeve të domosdoshme siç është ligji i pronave.

Prandaj si përfundim, që shteti të jetë i drejtë dhe efikas, qeveria duhet të jetë e vogël dhe të marrë pak role, të cilat nga ana tjetër, duhen përmbushur me rigorozitet. Kështu e shoh

edhe mënyrën sesi qeveria e djathtë duhet të organizhet, një qeveri me cabinet të vogël, por efikasitet të madh!

Pogradec, 13 korrik 2022

NEVOJA PËR NJË EDUKIM POLITIK TË RINISË



Megi Përduka

Ideologjitë janë një sistem idesh dhe idealesh, që përbëjnë bazën e teorisë dhe politikës ekonomike ose politike.

Përkatësisht, partitë me ideologji të djathta fokusohen në rolin qëndror të lirisë, në kufizimin e qeverisë dhe forcës shtërnguese të shtetit, pra kemi të bëjmë me liri të individit, treg të lirë, pronë private, taksë të sheshtë, shkurtimin e shpenzimeve publike dhe reduktimin e politikave sociale.

Specifikisht, Shqipëria, sipas meje, ka parti gjithëpërfshirëse të cilat nuk kanë ideologji të qarta dhe për më tepër nuk kanë asnjë kontrast ose dallim drastik midis tyre. Nëse një parti politike ka ideologji “të djathta” ajo fare mirë mund të promovojë edhe politika “të majta” dhe e kundërta.

P.sh. një parti politike në Shqipëri mund të identifikohet si parti me bindje “të djathta” dhe në programin e saj thuhet se do të ofrojë arsim falas, shëndetësi falas dhe mbron të drejtat e punëtorëve. E njëjta gjë ndodh edhe me partitë që në opinion njihen si parti “të majta” dhe në statut kanë mbrojtjen e biznesit dhe garantimin e konkurrencës në treg.

Thënë shkurt, ideologjitë politike nuk kanë asnjë llojë rëndësie për partitë shqiptare, përkundrazi, këto parti janë të gatshme të përfshijnë në programet e tyre çfarëdo politike që në sytë e elektoratit mund të duket e hijshme.

Por nëse në Shqipëri do të implementohej realisht një ideologji e djathtë, a do të ndryshonte zhvillimi i vendit tonë? Unë, besoj thellësisht se po.

Por, gjithashtu besoj se zhvillimi e ka zanfillën gjithmonë te një edukim i mirë. Edukimi ndikon si në formimin e personit tuaj po ashtu dhe llojin e jetës që zgjidhni të jetoni, qoftë kjo jetë me impakt negativ apo pozitiv në fund të rrugëtimit.

Një nga këto ndikime, që ne e marrim në bazë të edukimit që në vegjëli është edhe ideologjia politike. Vlerat me të cilat ju jeni rrethuar ose vlerat që keni parë tek të afërmit tuaj, në fund të ditës bëhen edhe vlerat në të cilat ju besoni. Si fëmijë është shumë e lehtë të impresionohesh, keshtu që ti beson çdo gjë që prindërit e ty bëjnë ose thonë dhe është shumë e vështirë të dalësh nga kjo mendësi që është rritur bashkë me ty. Në pamje të parë nuk ka asgjë të gabuar me këtë, është thjesht një mënyrë jetese.

Problemi në Shqipëri qëndron tek fakti se nuk jemi edukuar me ideologji politike, për të mos thënë që prindërit, në të shumtën e rasteve i edukonin fëmijët me idenë që mos u përfshi në politikë, sepse kjo nuk të sjell asgjë të mire. Mbase edhe kjo është një nga arsyt pse populli shqiptar është “injorantë” në njohjen e ideve politike politike dhe pranon çfardolloj lideri që i serviret. Pra, tendenca është për të parë partitë përmes liderëve të tyre dhe jo liderët përmes ideve që mbrojnë. Kemi një popull të politizuar, por që prodhon pak politikë.

Nëse sot do fillojmë të edukojmë të rinjë me mendime të djathta dhe konservatore, pas disa vitesh në Shqipëri do të jetë arritur që, në qendër të çdo gjëje të vendosin individualizmin

dhe të drejtat e tyre. Individët, të cilët besojnë në limitimin e qeverisë, besojnë në biznes, në të drejtën e pronësisë dhe të drejtën e privatësisë.

Nuk e di, nëse të gjitha këto që shpreha më lartë do të sillnin zhvillim të sigurt në Shqipëri, por një gjë është e sigurt; nuk do lejonin qeverinë të shkelte me këmbë të drejtat themelore të qytetarëve të vet.

Pogradec, 13 korrik 2022

E DJATHTA, E VETMJA SHPRESË PËR NDRYSHIM



Mikaela Pinari

Shqipëria ka kaluar disa sisteme politike, që nga momenti kur shpalli pavarësinë e saj. Një prej tyre ishte edhe regjimi i egër komunist, i cili u rrëzua falë guximit të njerëzve që e donin demokracinë dhe vlerat e saj. Ndryshimet demokratike u bënë të mundura, falë organizimit dhe kontributit të partive me ideale të djathta, të cilat e drejtuan Shqipërinë drejt parimeve dhe vlerave evropiane, ku shoqëria jonë sot bën pjesë.

Me lindjen e shtetit demokratik shqiptar rilindën vlerat, parimet dhe synimi politik mbi të cilin u krijua “e djathta” në Shqipëri. Pasi qytetarët fituan lirinë e fjalës, të drejtën e pronës, biznesit etj, sfida të tjera lindën për të djathtën në Shqipëri. Një ndër sfidat më të mëdhaja mbetet anëtarësimi në familjen e madhe evropiane. Për të arritur këtu shumë procese dhe marrëveshje historike janë nënshkruar, pikërisht nga qeveria e djathtë shqiptare, si anëtarësimi i shtetit në NATO, e cila rriti sigurinë në rajon dhe e bëri Shqipërinë një faktor stabiliteti në ballkan dhe më gjerë. Gjithashtu, ofroi një lloj garancie për bizneset e huaja për të investuar kapitalin e tyre në Shqipëri.

Arritja tjetër e madhe e të djathtës Shqiptare ishte liberalizimi i vizave me BE. Të gjithë shqiptarëve iu dha mundësia të lëviznin lirisht në Europë, si të gjithë qytetarët e emancipuar europianë.

Ishin këto disa nga arritjet kryesore dhe faktorë kyç të ndikimit të së djathtës në Shqipëri. Jo më kot, pak më lart përmenda ato arritje, pasi sot ato ndihen dhe duken si histori, si diçka që me të drejtë u takojnë sot të rinjve dhe të rejave, por që është arritur falë ndikimit dhe vlerave të familjes politike së djathtë shqiptare.

Sot, në realitet, Shqipëria po përballlet me pasoja të mëdha nga lufta në Ukrainë, e cila ka sjellë një rritje galopante të çmimeve që janë bërë të papërbalueshme. Mënyra sesi po menaxhohet kjo situatë nga qeveria aktuale majtiste, e ka shtuar edhe më shumë barrën për qytetarët dhe bizneset në vend.

Në këtë situatë një politikë e djathtë e mirëfillte do të ulte menjëherë taksat për biznesin e vogël, do të ofronte një paketë ndihmë për qytetarë për të përballuar koston e shportës dhe do të rriste ndihmën ekonomike për familjet në nevojë.

Sigurisht, që investime të tilla si gazsjellësit transatlantici (TAP), i cili pati një ndikim ekonomik gati 10 vjeçar duke ndihmuar për më tepër dhe buxhetin e qeverive pasardhëse, ishte fryt i një përpjekjeje të gjatë të politikave të djathta, por në gjendjen aktuale, tërheqja e këtyre investimeve të huaja do të ishte shumë e vështirë.

Implementimi i një sistemi fiskal të qëndrueshëm, si përshtetshmëri tatimi i sheshtë mbi të ardhurat, minimizimi i ndarjes së bizneseve në disa kategori të taksueshme do të krijonte mjedisin e duhur për të thithur investimet e huaja në vend duke ndikuar në mënyrë direkte në rritjen e punësimit dhe të të ardhurave.

Zgjidhja njëherë e mirë e problematikës së kthimit të pronave tek pronarët, lehtësirat e të bërit biznes dhe shumë politika të tjera të djathta duhet të trajtohen në mënyrë përfundimtare, në një program të strukturuar kombëtar, ku kuadri ligjor të jetë i qartë për secilin grup interesi.

Sigurisht që përmirësimi i këtyre indikatorëve ekonomik dhe social do ta afrojë Shqipërinë me familjen evropiane. Vetëm partitë e djathta me politikat e tyre makro ekonomike, të fokusuara në liberalizimin e të bërit biznes me taksa të ulëta, do të sjellin një ekonomi konkurruese, të denjë për t'u bërë pjesë e tregjeve europiane.

Sfidat për të djathtën sot janë nevojat jetike që kanë qytetarët shqiptarë. E ardhmja nën drejtimin e të djathtës do të sjellë ndryshim real ekonomik dhe do të tregonte potencialin ekonomik dhe njerëzor të Shqipërisë. Vendi më i zhvilluar në BE, Gjermania, njohu zhvillimin e saj më të madh nën drejtimin e një qeverie të djathtë prej më shumë se një dekade dhe ky është shembulli dhe vizioni ku duhet të shohë e djathta shqiptare. E njëjta gjë ka ndodhur në të gjitha vendet ku e djathta dhe konservatorët reformatorë kanë qeverisur. Politikat liberale të ekonomisë së tregut dhe fuqizimi i sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme, kanë qenë përherë bosht i politikave ekonomike të qeverive të djathta. Reformat fiskale të së djathtës, nuk synojnë mbushjen e xhepit të madh të shtetit, siç bëjnë majtistët, por fuqizimin e xhepave të bankave nga të depozitat e individëve, të cilët rrisin indirect kapitalin e vendit.

Në zgjedhjet e ardhshme duhet të fillojë dekada e qeverisjes së djathtë në Shqipëri, sepse ajo mund të ofrojë ndryshimin real në vend dhe për të larguar një herë e përgjithmonë fjalën “tranzicion” nga konteksti politik dhe realiteti shoqëror nga vendi ynë i mrekullueshëm me pasuri të pafundme, me të cilat e ka bekuar Zoti.

Pogradec, 13 korrik 2022

ZHVILLIMI I SHQIPËRISË SIPAS IDEVE TË DJATHTA DHE KONSERVATORE



Sention Zotaj

Në çfarë besojmë ne? Ne besojmë në vlerat e jashtëzakonshme shqiptare. Populli shqiptar është një popull vital. Kjo platformë përcakton me gjuhë të qartë rrugën për ta bërë Shqipërinë Europiane dhe Kombin shqiptar të bashkuar në Europë.

1-Ekonomia:

Ekonomia jonë familjare dhe kombëtare është shkatërruar dhe grabitur, taksat janë përdorur për interesa politike dhe korruptive. Shqiptarët meritojnë një ekonomi të fortë dhe të shëndetshme. Taksa e sheshtë 9%, heqja e taksave për biznesin e vogël janë garanci për një zhvillimin ekonomik, mbështetjen e bizneseve, investimeve të huaja dhe punësimin e shqiptarëve.

2-Rajoni dhe BE:

Roli ynë në çështjet rajonale ka qënë një rol vendimtar jo vetëm për çështjen shqiptare por gjithë rajonin dhe si kandidat për

BE. Për fatin e keq jemi te fundit ne Raport me BE. Te gjitha këto janë eklipsuar nga problemet e krimit të organizuar dhe korrupsionit të lidhur me qeverinë. Kundërshtarët tanë në rajon u bënë në menyrë krejt naïve apo të qëllimshme partnerët tanë kryesorë duke I dhënë atyre një kredo politike te munguar me SHBA dhe BE.

3-Shqiptarët dhe Qeveria:

Ne besojmë se shqiptarët kanë një vlerë të jashtëzakonshëm në ballkan për shkak të prejardhjes, kulturës dhe historisë sonë. Ne besojmë në Kushtetutë si dokumentin tonë themelues. Ne besojmë se Kushtetuta nuk është shkruar si një dokument pa vlerë, por duhet të jetë e qëndrueshme si garanci e shqiptarëve për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe përcaktojnë qeverinë që duan.

4-Kushtetuta dhe qytetarët

Ne besojmë se sistemi kushtetues është shkatërruar dhe duhet rikthyer bazuar në parimet e qeverisë së kufizuar, ndarja dhe balancimi pushteteve dhe të drejtat e njeriut – këto duhet të ruhen pa kompromis. Ne besojmë se liria politike dhe liria ekonomike janë të pandashme. Kur liria politike dhe liria ekonomike ndahen - të dyja janë në rrezik; kur janë të bashkuar, ato janë të pamposhtur. Ne besojmë se njerëzit janë vlera me e madhe, njerëzit, jo qeveria, janë administratorët më të mirë të burimeve natyrore të vendit tonë.

5-Siguria:

Si shqiptar ne dëshirojmë paqe dhe siguri kështu që ne insistojmë me forcë se: Ne do ta bëjmë Shqipërinë të sigurt, ne luftë pa kompromis me korrupsionin dhe krimin e organizuar

si rreziqet kryesore kundër shqiptarëve dhe të ardhmes tonë Europiane.

Ne kërkojmë miqësi me të gjithë popujt dhe të gjitha kombet, por e njohim dhe jemi të përgatitur për t'u marrë me të keqen në ballkan. Ndryshimet gjeopolitike në Ballkan me një autoritet në rritje të Rusisë dhe kontroll ekonomik të Kinës vinë ndesh me interesat shqiptare të cilat kërkojnë vetë ndërgjegjësim politik dhe kombëtar për të ruajtur kursin tonë Euro-Atlantik.

6-Shëndetësia:

Ristrukturimi i shërbimit shëndetsor, përcaktimi i prioriteteve të shërbimit publik dhe privat me financime në nivelet e vendeve Ballkanike anëtare të BE është domosdoshmëri. Ne duhet t'u japim mundësinë e zgjidhjes shqiptarëve. Shëndetësia sot është e shkatërruar, mjekët dhe infermierët të papaguar dhe parespektuar,

7-Prona Private:

Rama dhe Rilindja kanë braktisur popullin Shqiptar dhe interesat kombëtare:

Borxhi kombëtar është rritur në mënyrë të pa precedentë duke krijuar një problem të madh për ekonominë kombëtare dhe familjare.

Prona private është cënuar si e drejtë e rëndësishme njerëzore dhe mundësi ekonomike. Konfiksi për pronën ka shkaktuar shumë viktima dhe ka prishur shanset për zhvillimin e ekonomisë familjare dhe kombëtare dhe frenuar investimet e huaja.

-Nëse korrupsioni dhe krimi organizuar kontrollojnë qeverinë, qeveria përpiqet të kontrollojë çdo liri dhe të drejtën tonë; po përpiqen të kontrollojnë shkollat, fermat, bizneset tona, madje edhe institucionet tona fetare.

-Rama ka sfiduar Kushtetutën, ligjet, bazën e lirive tona njerëzore dhe mundësive ekonomike, prandaj është detyra e çdo qytetari të luftojë për shtetin e qytetarëve; t'u kthjemë shqiptarëve kontrollin dhe fuqinë për të marrë vendimet e tyre në lidhje me atë që është më e mira për ata dhe familjet e tyre.

Shqipëria dhe shqiptarët duhet të refuzojnë të keqen dhe të bashkohen për të mirën.

Kushtetuta duhet nderuar, vlerësuar dhe mbështetur. Udhëheqësit duhet t'u shërbejnë njerëzve, jo interesave të veçanta!

Familjet dhe shoqëria duhet të jenë të forta dhe të lira nga ndërhyrja e qeverisë!

Institucioni i martesës tradicionale është themeli i shoqërisë!

Qeveria duhet të jetë më e vogël, më e aftë dhe më efikase!

Kultura duhet të respektojë dhe mbrojë jetën!

Fëmijëve dhe rinisë u duhet siguruar një sistem bashkëkohor edukimi!

Programet sociale duhet të ndihmojnë në nxjerrjen e njerëzve nga varfëria!

Pogradec, 13 korrik 2022

PSE IKIN TË RINJTË?



Tea Sollaku

Shqipëria, djepi ku u lindëm, rritëm dhe po jetojmë; aq e bukur, po aq dhe e shëmtuar, aq e pasur, po aq sa edhe e varfer ...

Eh, nëse rri dhe flas, ka aq shumë krahasime, që të japim pamjen tri dimensionale të Shqipërisë.

E, duke menduar, në moment lind një “Pse?” e madhe ..

Pse ikin të rinjtë?

Pse nuk zhvillohemi? Pse shoqëria është shndërruar në një qenie pa ndienja? Pse kështu? Pse ashtu? Ka pafund “pse” Aq shumë sa në një moment kthjellohesh dhe pyet veten; çfarë do të sugjeroja unë për të ndryshuar këtë relitet të hidhur?

Politika e krahut të djathtë, përgjithësisht karakterizohet nga mbështetja për pikëpamjen se, disa rende dhe hierarki shoqërore janë të pashmangshme, të natyrshme, normale ose të dëshirueshme, duke mbështetur në mënyrë tipike këtë pozicion në bazë të ligjit natyror, ekonomisë, autoritetit ose traditës.

Tri janë pikat kryesore, që unë mendoj se duhet t'u kushtojmë vëmendje urgjente:

1- Emancipimi i femrës

Ndoshta kjo është një çështje që mund të hap debat. Por unë do thoja se, nëse ne kemi mbështetur femrën kemi zhvilluar gjithë vendin! Është figura e saj ajo që rrit dhe frymëzon brezat e ardhshëm! Emancipimi i femrës nis që me edukimin e saj arsimor, me shancet që i jepen asaj në etapa të ndryshme të jetës, kur shfaq prirje dhe talent për profesione të ndryshme dhe deri tek përfshirja e saj në programe të karrierës dhe të mbështetjes financiare. Nuk mjafton bilanci numerik i përfshirjes sipërfaqësore të grave në politikë apo institucione publike; me rëndësi ka mbështetja e barabartë dhe e drejtë e të gjitha grave, duke u siguruar atyre liri në konkurim dhe barazi në gjykim. Nuk është numri i lartë I grave ministre në një cabinet qeveritar ai që tregon mbështetje të grave. Është përqindja e punësimit të përgjithshëm të grave dhe mbi të gjitha, buxheti që ata kanë, përqindja e pasurisë kombëtare që është në duart e grave. Kjo tregon forcën e saj dhe jo përfshirja në skema lëmoshe...

2- Arsimimi dhe mundësia e barabartë e punësimit

Në Shqipërinë tonë, ekzaktesisht në këtë periudhë që jetojmë është shumë vështirë të gjesësh një trajnim pa pagesë, një punë të re pa eksperiencë paraprake. Po përdor një term jo etik, por askush s'ka "nerva" me u marr me rininë dhe me i dhënë asaj mundësi për t'u zhvilluar. Prandaj duhet që një qeveri e djathtë të mendojë seriozisht për arsimimin dhe kualifikimin e të rinjve me qëllim që ata të kenë shance të barabarta punësimi dhe të mos mbeten rrugëve pa shpresë dhe të nënvlerësuar. Financimi i projekteve të rinisë, mbështetja e çifteve të reja me kredi të buta dhe projekte të tjera për familjen, do të rikthejnë shpresën që rinia të mos ikë, por të qëndrojë këtu!

3- Shëndetsia

E fundit, por jo nga rëndësia; një mjeksi e kualifikuar do të thotë një popull i shëndetshëm! Politika e investimeve në shëndetësi duhet rishikuar me themel, sepse deri tani duket se parësore janë koncensionet për privatët dhe jo kujdesi për popullin. Investimet në shëndetësi, duhen ndarë në disa fusha; së pari, investimet për arsimin në fushën e mjeksisë. Një qeveri e djathtë duhet që për edukimin shëndetësorë të shpenzojë më shumë, duke përfshirë edhe kualifikimet pas-universitare të mjekëve të rinj në klinika Brenda dhe jashtë vendit. Kushti bazë duhet të jetë që ata që kualifikohen të qëndrojnë për disa vite në vend dhe më pas mund të bëjnë zgjifhje të lirë individuale për të ikur jashtë vendit. Së dyti, duhet që buxheti për pagat në shëndetësi të jetë i barabartë me vendet e mesme europiane dhe të ketë lehtësira për mjekë që krijojnë familje të reja. Ato duhet të kenë përparësi në strehim dhe punësim të familjarëve. Një sektor tjetër ku duhet rishikim themelor I buxhetit është investimi në spitale dhe shërbime shëndetësore, duke ofruar mbështetje me ilaçe dhe logjistikë bashkëkohore. Skema e sigurimeve shëndetësore duhet liberalizuar dhe të gjithë ata që paguajnë për “sigurim shëndetësor”, në shtet apo provat, duhet të kenë të drejtë të jenë të siguruar kudo që shkojnë, sepse në fund të fundit ata kanë paguar për shëndetin e tyre dhe mjekimin mund dhe duhet ta bëjnë në çdo spital Brenda vendit, pa pengesa.

Këto dhe disa ide të tjera, që unë kam për frenimin e emigracionit, në fakt lidhen me nevojën e një platform më gjithëpërfshirëse që duhet ta krijojnë partitë e djathta dhe konservatore në Shqipëri, për të përmbyllur kapitullin e të ashtuquajturit “tranzicion” dhe hapjen e një kapitulli të ri, që lidhet me një Shqipëri europiane, ku të gjithë kanë një të ardhme të garantuar.

Ajo qeveri dhe politikë që frenon ikjen e rinisë, ajo siguron një Shqipëri të re!

Pogradec, 13 korrik 2022

VLERAT E SË DJATHTËS SHQIPTARE



Valbona Halitaj

Procesi i zhvillimit dhe ndërtimit të shtetit dhe shoqërisë shqiptare në keto 110 vite, ka hasur vështirësi dhe pengesa në krijimin dhe formimin e strategjive të duhura drejt shtetformimit dhe integritetit fillestar në familjen e madhe europiane. Historia jonë njeh dhe përngjan me një luftë konstante ideologjike, e cila ka sjellë vetëm iluzionin e krijimit të themeleve të shtetit shqiptar. Zhvillimi normal i shoqërisë nuk ka qenë i mundur, si pasojë edhe e pushtimeve qindra vjeçare, të cilat detyrimisht nuk kanë lejuar as kalimin e rendeve shoqërore, proces ky i cili ka ndodhur shumë më herët në Europë. Kjo ka qenë një fatkeqësi jo vetëm për një nga kombet më të vjetra europiane, por edhe një prej kombeve si pjesë e aristokracisë gjatë drejtimit të popullit shqiptar nga Gjergj Kastrioti dhe qytetarëve shqiptarë gjatë mbretërisë së Zogut. Më tej, për fatkeqësinë tonë, rregjimi komunist dhe instalimi i ideve dhe parimeve ekstreme të majta, frenoi dhe ndaloi për gati gjysëm shekulli zhvillimin e Shqipërisë, në rajon dhe në arenën ndërkombëtare. Koha më errët për Shqipërinë dhe shqiptarët që fiku çdo dritë shprese për zhvillim dhe prosperitet, e cila mund të na afronte sadopak

me fqinjët tanë, vonoi po ashtu dhe mundësinë apo krijimin e djathtës së mirëfilltë shqiptare.

U desh gjysëm shekulli, që kjo të ndodhte. Nuk ka qenë një mision i lehtë, për të djathtën, sepse ajo ka qenë në gjithë këto vite tranzicioni një lloj demokracie në luftë me kohën dhe, në rastin më të keq përballë një komunistizimi modern. Implementimi i filozofisë së djathtë në jetën politike dhe në spektrin politik shqiptar, nëpërmjet parimeve të saj, ka bërë që Shqipëria të njohë kohën më të mirë të integritetit dhe modernizimit të saj kur përqafoi idetë dhe parimet e djathta, si ekonomia e lirë e tregut, konservatorizmi shoqëror, pro- europianizimi dhe mbrojtja e të drejtave kombëtare të shqiptarëve.

E djathta shqiptare ka qenë patriotike, në raport me atdheun, ku theksohej jo thjeshtë mbrojtja dhe kontrolli i kufijve, por mbrojtja dhe promovimi i vlerave kombëtare. Për herë të parë, e djathta artikuloi “interesin kombëtar” jo thjeshtë si togfjalësh politik, por si një strategji të mirëfilltë për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në rajon. Ajo dha kontribut të madh për lirinë dhe pavarësinë e shqiptarëve në Ballkanin Perëndimor. E djathta e re shqiptare e pas viteve '90, nuk ishte një e djathtë nacionaliste, por një e djathtë patriotike!

Qeveria e vogël dhe taksat e ulëta, si model i zhvillimit gjithëpërfshirës, ashtu sikurse familja, besimi, vota e lirë dhe prona private sollën edukimin e shoqërisë shqiptare me filozofinë kombformuese të së djathtës tradicionale, si rruga e vetme për zhvillimin e Shqipërisë, përkundër metodave globaliste të së majtës dhe përmbysjes së rendit kushtetues me dhunë, të cilat shoqëria dhe shteti shqiptar kishte njohur gjatë peridhës së komunizmit. Ishin këto arsye, të cilat bënë që Shqipëria të shikonte pas gjithë atyre viteve errësire, dritën e zhvillimi, ku kjo më pas u shpërblye për shqiptarët me futjen e Shqipërisë në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, Liberalizmin e vizave në familjen e madhe europiane, etj.

Vetë procesi i demokratizimit të së djathtës shqiptare, për fat të keq është ende një proces në tranzicion, i cili po kërkon kohën e vet për konsolidim. Por, pavarësisht të gjithë vështirësive dhe pengesave që vijnë nga reminishencat dhe mbetjet e komunizmit, shqiptarët në kohën e duhur do të dinë të përqafojnë sërish vlerat dhe idetë e të djathtës europianiste shqiptare.

Pogradec, 13 korrik 2022

FOTO NGA SHKOLLA POLITIKE VERORE











